



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 358, datë 14.09.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatores znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

EKSTRAKT

RAPORT  
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARES  
{...}  
VITI 2019

POLI I DREJTËSISË  
RRUGA “ANA KOMNENA”  
TIRANË

---

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E  
VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR  
ÇDO KRITER VLERËSIMI**

---

**1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

**1. A Njohuritë ligjore.**

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile, është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi pa qenë e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, nga e cila do të përcaktohet më pas natyra juridike e saj, e për pasojë edhe referenca relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

**- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, fakt ky i integruar me provat. Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar, gjykim penal, apo kërkesë me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale*), rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arsytuese të vendimit, pas parashtrimit të

rrethanave procedurale dhe si një nën pjesë e titulluar "Rrethanat e faktit". Tipar karakteristik i gjyqtarës është analiza e detajuar e provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzioneve mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me llojin e marrëdhënies juridike civile ndërmjet palëve.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje me provat e administruara gjatë gjykimit.<sup>1</sup> Gjithashtu gjyqtarja në nxjerrjen e faktit juridik, bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse por edhe provave të mara kryesisht, apo në kryerjen e akteve të ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme.<sup>2</sup> Në të gjitha vendimet e analizuara konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

### ***-Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi/shërbimi*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion dhe përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë, dhe këtë e pasqyron pothuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi (*si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale*) në pjesën e parë përshkruese - arsyetuese duke analizuar shkurtimisht juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes. Nga vëzhgimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes, edhe kur nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

### ***- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar vendimeve burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt

<sup>1</sup> Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019 dhe vendimi nr. (1119) - 334 datë 18.11.201 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>2</sup>Vendimi nr. (1202) - 360 datë 11.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile/familjare dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (përmbushje detyrimi, zgjidhje martesë), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse që kanë lidhje me:

- a) *Veprimet juridike dhe lindjen e detyrimeve juridike civile*, duke cituar për këtë qëllim dispozitat ligjore materiale (nenin 79 të K. Civil) në lidhje me kuptimin e përgjithshëm të veprimit juridik civil, apo dispozitat ligjore materiale (nenin 419, 420, 455, 463 të K. Civil) mbi krijimin dhe lindjen e detyrimeve juridike civile. Citon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” për të përcaktuar të drejtat, detyrimet dhe mënyrën e shpërblimit të avokatit për shërbimin e ofruar (neni 16 i ligjit). Citimi i këtij ligji të posaçëm dhe dispozitave të Kodit Civil mbi lindjen e detyrimeve juridike civile, si norma relevante, bëhet nga ana e gjyqtarës jo vetëm duke iu referuar pretendimit të palës paditëse mbi objektin e kërimit, por duke iu referuar cilësimit të saktë të faktit juridik civil mbi bazën e provave objekt gjykimi.
- b) *Zgjidhjen e martesës dhe pasojat që rrjedhin prej saj*<sup>3</sup>, ku identifikon dhe citon dispozitat ligjore të Kodit të Familjes (nenin 1, 50, 132, 133, 146, 155, 161, 192, 197 dhe 201 të K. Familjes) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj.

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes dhe kërkesat procedurale të palëve. Konkretisht gjyqtarja citon dispozitat procedurale civile (nenin 6, 14, 16, 17, 28 të K.Pr.Civile) në funksion të respektimit të rregullave procedurale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile mbi legjitimitetin aktiv dhe pasiv, si dhe interesin e ligjshëm për të kërkuar rivendosjen në vend të së drejtës së pretenduar<sup>4</sup>. Identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (nenin 134 të K.Familjes) në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim duke zhvilluar seancën e pajtimit (në këtë rast neni 134 i K. Familjes citohet si një dispozitë procedurale) në mënyrë të detyrueshme sipas kriterëve të parashikuara në këtë dispozitë. Po kështu gjyqtarja citon dispozitat procedurale civile (nenet 36/1, 41, 42, 50, 51, 59 të K.Pr.Civile) në lidhje me përcaktueshmërinë e juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore në shqyrtimin e çështjes civile apo familjare.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht:

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. (1202) - 360 datë 11.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>4</sup> Vendimi nr. (1119) - 334 datë 18.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

- a) Identifikon dispozitat materiale (*nenin 205, 242 apo 135 të K. Penal*) në funksion të cilësimit juridik të veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit në çështjet penale burim vlerësimi.<sup>5</sup>
- b) Citon dispozitat ligjore materiale (*nenin 278/2 të K.Penal*) në funksion të përcaktimit të ekzistencës së faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri (*tek analiza e dërgimit të çështjes në gjyq*) si dhe dispozitën materiale (*nenin 283 apo 186/1 të K.Penal*) në funksion të analizës së elementëve ligjore të kësaj figure veprave penale, mbi mungesën e përgjegjësisë penale në lidhje me faktin juridik (*në funksion të analizës së pranimit të kërkesës për pushimin e çështjes ndaj personit nën hetim*)<sup>6</sup>.
- c) Në çdo rast, referohen dispozita të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, ashtu dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit dhe aplikimin e alternativave të dënimit (*nenet 47, 48, 49, dhe neni 59 i K.Penal*).<sup>7</sup> Në individualizimin e dënimit, gjyqtarja mban në konsideratë dhe përdor për këtë qëllim edhe udhëzimin nr. 2 datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë mbi përcaktimin e elementëve të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit.

Përpos dispozitave materiale të K. Penal, gjyqtarja identifikon dhe citon për këtë qëllim edhe ligjet e posaçme në ato raste kur vetë fakti penal të referon, në lidhje me:

- a) *Veprën penale të prerjes së paligjshme të pyjeve*. Duke qenë se neni 205 i K. Penal është një dispozitë “blankete”, gjyqtarja referon dhe analizon për këtë qëllim edhe dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9385 datë 04.05.2005 “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*” të ndryshuar (*nenin 38 të ligjit*) si dhe VKM - të e dala në zbatim të ligjit të posaçëm.
- b) *Veprën penale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike*. Duke qenë se neni 283 i K. Penal është gjithashtu një dispozitë «blankete» (e bardhë), për përcaktimin e elementëve të veprës penale i referohet ligjit nr. 7975 datë 26.07.1995 «*Për barnat narkotike dhe psikotrope*» që parashikon llojet e bimëve dhe lëndëve narkotike dhe që rregullon procedurën e pajisjes me leje për kultivimin e bimëve dhe lëndëve narkotike.<sup>8</sup>

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtarja ka referuar në çdo rast, si pjesë e integruar e arsytimit të vendimit:

- a) Dispozita të ligjit procedural penal (*nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës;<sup>9</sup> Duke u nisur nga natyra e çështjes dhe kërkesave të parashtruara nga ana e organit të akuzës referuar fazës procedurale të çështjes, përcakton

<sup>5</sup> Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019, vendimi nr. (481) - 68 datë 23.05.2019 dhe vendimi nr. (1031)-144 datë 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>6</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë vendimi 11.06.2019 dhe vendimi penal nr. (1166) - 448 datë 02.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>7</sup>Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019, vendimi nr. (481)-68 datë 23.05.2019 dhe vendimi nr. (1031)-144 datë 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>8</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë 11.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>9</sup> Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019, vendimi nr. (481) - 68 datë 23.05.2019 dhe vendimi nr. (1031) -144 datë 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake sipas nenit 327/6 në lidhje me nenet 329/a dhe b dhe 332 të K.Pr.Penale;<sup>10</sup>

- b) Procedurën e gjykimit të shkurtuar (*nenet 403, 405 dhe 406 të K.Pr.Penale*)<sup>11</sup>; dispozitat ligjore lidhur me çmuarjen e provave dhe vlerën provuese të tyre (*nenin 152 të K.Pr.Penale*);<sup>12</sup>
- c) Përcakton natyrën e çështjes (*seancë paraprake - dërgim në gjyq së bashku me kërkesën për pushimin e procedimit penal për njërin nga të pandehurit*), duke cituar për këtë qëllim në mënyrë specifike edhe dispozitat procedurale të ndryshuara me ligjin nr. 35/2017 në lidhje me qëllimin e këtij instituti, funksionin dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake (*nenet 332/a, 332/b, 332/ç pika 1 dhe neni 332/c /pika 3, neni 332/dh pika 1 shkronja ç, 3 të K.Pr.Penale, nenin 331 në lidhje me nenin 327 pika 2 e K.Pr.Penale, etj*), dispozitat procedurale penale të ndryshuara në lidhje me pushimin e çështjes apo të akuzës (*nenet 328 dhe 329 të K.Pr.Penale*)<sup>13</sup>;
- d) Në vendimin me objekt vlefësimin e arrestit dhe caktim mase sigurimi, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së arrestit (*nenin 251 dhe 252 të K.Pr.Penale*) dhe vlerësimin që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit.<sup>14</sup>

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimin për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimin, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

<sup>10</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë 11.06.2019 dhe vendimi nr. (1166) - 448 datë 02.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>11</sup> Vendimi nr. (1031)-144 datë 29.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>12</sup> Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019, vendimi nr. (481) - 68 datë 23.05.2019 dhe vendimi nr. (1031) -144 datë 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>13</sup>Vendimi nr. (1166) -448 datë 02.12.2019 dhe vendimi nr. (540) - 184 datë 11.06.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>14</sup>Vendimi nr. 132 datë 27.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në çdo rast citimi i dispozitave është shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin teleologjik të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), por edhe sipas interpretimit literal e gramatikor, apo sistematik të normave dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

*(i) Në vendimet civile:* Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- a) Referuar interpretimit literal të normës relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi lindjen dhe mënyrat e marrëdhënies juridike të shërbimit të avokatit, gjykata konkludon se nuk ekziston marrëdhënia juridike e shërbimit (*marrëdhënie avokat - klient*) midis palës paditëse dhe palës së paditur. Ky konkluzion mbështetet nga kriteret e parashikuara në nenin 16 të ligjit të posaçëm nr. 55/2018 dhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil mbi lindjen e detyrimeve si dhe provave të administruara në gjykim. Në analizën juridike për të përcaktuar nëse është i mbështetur pretendimi i paditësit në lidhje me dëmshpërblimin mbi punën dhe shërbimin e ofruar, gjyqtarja ndalet në mënyrë të detajuar jo vetëm në interpretimin literal të normës relevante (*tek ligji i posaçëm*) duke përcaktuar se cilat janë mënyrat dhe format e këtij shpërblimi, por edhe tek vetë qëllimi që ka pasur parasysh ligjvënësi me këtë dispozitë, duke konkluduar në rrëzimin e kërkesë padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv të të paditurit.<sup>15</sup>
- b) Interpreton dispozitën materiale, nenin 132 të K. Familjes në lidhje me shkaqet e zgjidhjes së martesës. Referuar interpretimit literal, gramatikor dhe logjik të dispozitës gjyqtarja arrin në konkluzionin se përmbushen në mënyrë kumulative të dyja kushtet e parashikuara në të, si humbja e qëllimit të martesës dhe pamundësia e vazhdimit të jetesës së përbashkët ndërmjet bashkëshortëve, pikërisht për shkak të atyre shkaqeve që citohen jo në mënyrë shteruese në nenin 132 të K. Familjes. Interpreton dispozitat materiale në lidhje me zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin

---

<sup>15</sup>Vendimi nr. (1119) - 334 datë 18.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec



nga mbarimi i martesës siç është ajo e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimit për ushqim, të cilat janë pasoja ligjore që nuk lidhen me kërkimet e palëve.<sup>16</sup>

(ii) *Në vendimet penale*: Interpreton dispozitat materiale në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Kryesisht konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të K. Penal duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, dhe në vijim, duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit<sup>17</sup>. Përgjithësisht konstatohet se dispozitat e Kodit Penal (*të pjesës së posaçme*) analizohen në të katër elementët e figurës së veprës penale e duke u përqendruar më tepër në anën objektive të saj. Në ato raste kur dispozita e pjesës së posaçme të K. Penal në lidhje me veprën penale që i atribuohet të pandehurit është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja zbaton edhe ligjet e veçanta ku të referon fakti penal.<sup>18</sup>

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, në çdo rast gjyqtarja interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh.: (i) në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) duke u ndalur dhe analizuar gjithashtu në mënyrë të detajuar elementët e përcaktuara në udhëzimin nr. 2 datë 14.03.1979 të Udhëzimit të Plenumit të Gjykatës së Lartë mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale (*objekti, vendi, koha, gjendja në të cilën është kryer vepra penale, rrethanat e kryerjes së saj, nëse është e përhapur në atë rreth ku është kryer*) dhe rrezikshmërinë e autorit (*gjendja sociale, profesioni, arsimimi, gjendja familjare, gjendja gjyqësore, shkalla e fajit dhe rrethanat lehtësuese*)<sup>19</sup>; (ii) interpreton dispozitën materiale penale (*nenin 59 të K.Penal*), në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit. Në këto raste, gjyqtarja ndalet kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri një dënim alternativ siç është ai i parashikuar në nenin 59 të K. Penal.<sup>20</sup>

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm përsa i përket aspekteve meritore, por edhe atyre procedurale në rastin kur ngrihen çështje të procedurës<sup>21</sup>, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel si p.sh çështjet

---

<sup>16</sup>Vendimi nr. (1202) -360 datë 11.12..2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec

<sup>17</sup> Vendimi penal nr. (392) - 48 datë 26.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, vendimi penal nr. (481) - 68 datë 23.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe vendimi nr. (1031) – 144 vendimi, datë vendimi 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec

<sup>18</sup> Konkretisht në vendimin nr. (392) - 48 datë 26.04.2019, duke qënë se neni 205 i K.Penal është një dispozitë blakete, gjykata i referohet dhe interpreton për këtë qëllim edhe dispozitat e ligjit të posaçëm, ligjit nr. 9385 datë 04.05.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*" të ndryshuar (*nenin 38 të ligjit*) si dhe VKM - të e dala në zbatim të tij.

<sup>19</sup>Vendimi penal nr. (481) - 68 datë 23.05.2019 dhe vendimi nr. (1031) – 144 vendimi, datë vendimi 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>20</sup> Vendimi nr. (1031) – 144 datë 29.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>21</sup> Shih për më tepër vendimin nr. (392) - 48 datë 26.04.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në të cilën gjykata referuar kërkesës së organit të akuzës mbi kalimin e akteve prokurorit, interpreton në mënyrë literale dhe gramatikore nenin 377 të K.Pr.Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, sipas së cilës në këtë dispozitë nuk parashikohet në asnjë moment kalimi i akteve organit të akuzës në fazën e gjykimit të çështjes penale, duke e pasur këtë të drejtë organi i akuzës vetëm në seancë paraprake (dërgim në gjyq).

e seancave paraprake<sup>22</sup> apo në kërkesën penale për vlefësimin e arrestit dhe caktimit të masave të sigurimit<sup>23</sup>. Konkretisht:

- a) Në vendimet e kategorisë së çështjeve seancë paraprake (*dërgim në gjyq apo edhe kërkesë për pushimin e procedimit penal*), gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë interpretimit të normave procedurale penale të shtuara me ligjin 35/2017 (*nenet 329/a, 331, 332 e vijues të K.Pr.Penale*) në lidhje me këtë institut të ri të së drejtës procedurale (seanca paraprake) në funksion të përcaktimit të qëllimit, funksionin e kësaj faze procedurale si dhe detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake.<sup>24</sup>
  - b) Në kërkesën penale, me objekt vlefësim arresti dhe caktim mase sigurimi, në funksion të përcaktimit nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit, gjyqtarja nuk ndalet vetëm në trajtimin teorik të interpretimit teleologjik dhe literal të dispozitave procedurale përkatëse (*nenet 228,229 dhe 230 të K.Pr.Penale*) por i interpreton ato në përputhje me provat dhe rrethanat e çështjes.
- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante:***

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendime të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e GJEDNJ-së*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- a) *Standardin e të provuarit*, duke cituar dhe zbatuar për këtë qëllim vendimin nr. 196 datë 12.06.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; - *parimin tej çdo dyshimi të arsyeshëm*, duke cituar vendimin unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 të Gjykatës së Lartë, *parimin e prezumimit të pafajësisë*, duke zbatuar edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese (*nr. 9 datë 28.04.2004, nr. 19 datë 18.09.2008 etj*) dhe vendimet e GJEDNJ-së (*vendimet Barbera etj vs Spanja 1994, Janosevic vs Suedise 2002 etj*)<sup>25</sup>
- b) *Gjykimin e shkurtuar*; Konstatohet se nga ana e gjykatës është cituar dhe zbatuar në pranimin ose jo të kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2 datë 29.01.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.<sup>26</sup>
- c) *Caktimin e masave të sigurimit*; Gjykata mbështet konkluzionin e saj në ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm dhe caktimit të masës së sigurimit ndaj personit nën hetim, në përputhje me orientimet e vendimit unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimit unifikues nr. 3 datë 27.09.2002, vendimi unifikues datë 08.01.2009, të Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e duke cituar edhe jurisprudencën përkatëse të kësaj gjykate në çështjen *Fox, Cempbell dhe Hatley vs Mbretërisë së Bashkuara*, çështjen *Loukanov vs Bullgarisë*.<sup>27</sup>
- d) Kushtet dhe kriteret e ngritjes së padisë (*objektin dhe shkakun ligjor të padisë*,

<sup>22</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë vendimi 11.06.2019 dhe vendimi nr. (1166) - 448 datë 02.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>23</sup>Vendimi nr. 132 datë 27.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>24</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë vendimi 11.06.2019 dhe vendimi nr. (1166) - 448 datë 02.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>25</sup>Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>26</sup> Vendimi nr. (1031) – 144 datë 29.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>27</sup> Vendimi nr. 132 datë 27.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

*legjitimin real aktiv dhe pasiv, dhe interesin e ligjshëm për të ngritur padi*). Gjyqtarja citon dhe mbështet konkluzionin e saj për rrëzimin e padisë për shkak të mungesës së legjitimitetit real pasiv të të paditurit, edhe në jurisprudencën relevante si vendimet unifikuese nr. 3/2012 të Gjykatës së Lartë si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë vendimet nr. 91 datë 19 Mars 2009, vendimin nr. 800 datë 06 Qershor 2006, si dhe vendimin nr. 353 datë 5 Korrik 2011.

Gjithashtu konstatohet identifikimi i Kushtetutës apo Konventave Ndërkombëtare, kryesisht Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: neni 5 (ndalimi me ligj), neni 8 (e drejta për një jetë familjare) dhe neni 6, për të ardhur në ndihmë të interpretimit të ligjit të zbatueshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor, apo Konventës “Për të drejtat e fëmijëve” dhe akteve të tjera ndërkombëtare në mbrojtje të të miturve në proces.<sup>28</sup>

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:**

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakti i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit. Gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit siç janë:

- (i) *Parimi i prezumimit të pafajësisë* të sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, në nenin 30 të Kushtetutës apo në nenin 6 pg 2 të KEDNJ-së, dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”,<sup>29</sup>
- (ii) *Parimin e interesit më të lartë moral dhe material të fëmijëve të mitur*, duke cituar për këtë qëllim nenin 2 dhe 5 të K. Familjes si edhe nenin 3 të Konventës së OKB “Mbi të drejtat e fëmijëve” si dhe Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës, të njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në lidhje me të drejtën e takimit mban në konsideratë edhe *të drejtën për jetë familjare* të sanksionuar në nenin 8/1 të KEDNJ-së<sup>30</sup>;
- (iii) *Parimin e ligjshmërisë* – nullum crimen, nulla poena sine culpa, i nxjerrë nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale;
- (iv) Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit si dhe të humanizmit* (neni 1/c i K.Penal)<sup>31</sup>;
- (v) Në interpretimin e normave procedurale penale të ndryshuara mbi gjyqtarin e seancës paraprake, gjyqtarja përmend dhe citon se këto elementë respektojnë *parimin e ligjshmërisë, parimin e ekonomisë gjyqësore*, të respektimit të parimit kushtetues të hetimit dhe *gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, të respektimit dhe garantimit të të drejtave të viktimave në një proces penal, garantimin e parimit kushtetues *të dhënies së drejtësisë nga gjykata*.<sup>32</sup>

## **KONKLUZIONE:**

<sup>28</sup>Vendimi nr. (1202) -360 datë 11.12..2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>29</sup>Vendimi nr. (392) - 48 datë 26.04.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec

<sup>30</sup>Vendimi nr. (1202) -360 datë 11.12..2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>31</sup>Vendimi nr. (1031) - 144, datë 29.10.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

<sup>32</sup>Vendimi nr. (540) - 184 datë 11.06.2019 dhe vendimi nr. (1166) - 448 datë 02.12.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta, të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (*gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”*). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, parimet apo institutet në përgjithësi përdoren në gjuhën shqipe, dhe në ato raste të përdorimit të termave latine,<sup>33</sup>jepet kuptimi tyre në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe në disa raste edhe duke i numërtuar.

---

<sup>33</sup>Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

### **1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.**

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër. Pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Çështje, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) apo CRAC (*Konkluzion, Ligj, Argumentim, Konkluzion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe KONKLUZIONE i arritur.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Gjyqtarja {...} ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, jo vetëm prezantimit të fakteve dhe identifikimit të ligjit të zbatueshëm por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces.

*Pjesa përshkuese arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj si: procedura, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, legjislacioni i zbatueshëm apo vlerësimi dhe analiza juridike, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (ii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) ligjin e zbatueshëm duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale penale dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik civil apo

penal për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe (iv) vlerësimi i gjykatës në të cilën merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

*Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë), apo në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (deklarimin fajtor por edhe deklarimin e pafajshëm), dënimin dhe masën e dënimit, por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.*

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenin 245 të K.Pr.Penale në vendimin e kërkesës së hetimeve paraprake, (iii) nenin 332/e të K.Pr.Penale në vendimet seancë paraprake apo (iv) nenit 383 të K.Pr.Penale në vendimet penale. Po kështu vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë çka lehtëson kuptueshmërinë e arsytimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Në tërësi nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata (*kryesisht konstatohet tek vendimi i vleftësimit dhe caktimit të masës së sigurimi shtrimi i çështjeve për zgjidhje sipas metodës IRAC*) duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjykata. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor. Gjyqtarja përdor një metodë të caktuar në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtje të tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme.<sup>34</sup>Ndonëse nuk kërkohet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta e një vendimi të arsyetuar bën pjesë në të drejtën e një gjykimi të drejtë siç garantohet nga neni 6, pika 1 i KEDNJ-së, dhe gjen zbatim si në çështjet civile ashtu dhe ato penale. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.<sup>35</sup> Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin të vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore (*si p.sh.; interesi ligjshëm për të ngritur padi e për rrjedhojë kushtet për të gëzuar legjitimitet aktiv dhe pasiv, konceptet ligjore të pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e martesës si kërkime që nuk marrin formë të prerë në mënyrë substanciale por vetëm formale, gjendja e flagrancës, dyshimi i arsyeshëm, seanca paraprake, detyrat e gjyqtarit të seancës paraprake, etj.*), në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në një vendim gjyqësor,<sup>36</sup> argumenti rrjedh nga çështja apo pyetja ligjore e parashtruar nga ana e gjyqtarës për zgjidhje në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe hap pas hapi evidentohet argumentimi me të cilin gjyqtarja i përgjigjet çështjes. Ndërkohë në vendimet e tjera burim vlerësimi nuk është ndjekur kjo mënyrë, por edhe pse jo në mënyrë të shprehur (*ngritja e çështjes apo pyetjes ligjore në mënyrë eksplicite*), ajo vjen e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor.

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzioneve për zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak – pasojë.

---

<sup>34</sup> Neni 142 i Kushtetutës së RSH-së.

<sup>35</sup> Vendimi i GjEDNJ, Çështja "Suominen kundër Finlandës", 24 korrik 2003, paragrafët 34-38 si dhe çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33

<sup>36</sup>Vendimi nr. 132 datë 27.07.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale.

## KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos qëndrimeve të praktikës gjyqësore. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse. Në vendimet gjyqësore dominon pjesa analitike nga ajo përshkruese e fakteve, qoftë në rastin e interpretimit të provave ashtu dhe kur dispozitat e interpretuara zbatohen mbi çështjet e shtruara për zgjidhje.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore:

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda afateve ligjore të parashikuara në K.Pr.Penale dhe K.Pr.Civile. Nga 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) çështje gjithsej që kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, rezulton se kanë përfunduar tej afatit 25 (njëzet e pesë) prej tyre ose 18.1%: Konkretisht:*



- (i) Në tabelën nr.2 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, rezulton që vetëm 9 (nëntë) çështje kanë të parashikuar afat ligjor. Konkretisht çështjet me nr. 4, 7, 10, 11 dhe 17 rendor, me objekt “kundërshtim i veprimeve përmbartimore”, përt të cilat parashikohet afati 20 ditë për përfundimin e gjykimit (*neni 610 i K.Pr.Civile*), çështjet me nr. 1, 9, 12 rendor janë çështje me objekt “caktim përfaqësuesi ligjor”, për të cilat parashikohet afati ligjor 10 ditë për përfundimin e tyre (*neni 522 të K.Pr.Civile*) dhe çështja me nr. 31 rendor, me objekt “sigurim padie” për të cilën parashikohet një afat prej 5 ditësh për përfundimin e saj, konform nenit 202/1 të K.Pr.Civile. Nga 9 (nëntë) çështje të cilat kanë të parashikuar afat ligjor si më sipër cituar, rezulton se 5 (pesë) prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor të parashikuar në ligj dhe më konkretisht çështjet me nr. 1, 9, 10, 11 dhe 12 rendor.
- (ii) Në tabelën nr. 3 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, rezulton që 6 (gjashtë) çështje kanë të parashikuar afat ligjor. Konkretisht për çështjet me objekt “lëshim i urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes”, për të cilën parashikohet një afat prej 20 ditësh për përfundimin e tyre sipas ligjit 47/2018, të ndryshuar. Nga të dhënat rezulton se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm.
- (iii) Në tabelën nr. 8 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*penale krime*”, rezultojnë 11 (njëmbëdhjetë) çështje me objekt miratim marrëveshje që kanë të parashikuar afat ligjor, dhe vetëm 2 (dy) prej tyre, çështjet me nr. 10 dhe 11 rendor, kanë përfunduar tej afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 406/dh, pg 2 i K.Pr.Penale.
- (iv) Në tabelën nr. 9 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*kundërvajtje penale*”, rezultojnë 5 (pesë) çështje me objekt miratim marrëveshje që kanë të parashikuar afat ligjor dhe vetëm 1 (një) prej tyre, çështja me nr. 3 rendor, ka përfunduar tej afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 406/dh, pg 2 i K.Pr.Penale.
- (v) Në tabelën nr. 10 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, rezultojnë 72 (shtatëdhjetë e dy) çështje që kanë të parashikuar afat ligjor dhe vetëm 1 (një) prej tyre ka përfunduar tej afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 291 të K.Pr.Penale.
- (vi) Në tabelën nr. 11 me të dhëna statistikore, për çështjet e kategorisë “*seanca paraprake*”, rezultojnë 72 (shtatëdhjetë e dy) çështje, nga të cilat 37 (tridhjetë e shtatë) çështje janë kërkesa për pushimin e procedimit penal për të cilat në ligj nuk parashikohet afat ligjor por standard minimal kohor. Ndërsa 35 (tridhjetë e pesë) çështje me objekt dërgim i çështjes në gjyq kanë të parashikuar afat ligjor prej 30 ditësh për përfundimin e tyre. Nga këto 35 çështje rezulton se 16 (gjashtëmbëdhjetë) prej tyre kanë përfunduar tej afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 332/3 të K.Pr.Penale.

**Gjyqtarja në formularin e integruar** ka theksuar se ka respektuar afatin e parashikuar në ligj për përfundimin e çështjes, dhe në ato raste kur nuk është respektuar ky afat, kjo ka ardhur për shkaqe të pavarura prej saj, kryesisht për shkaqe tërësisht objektive dhe në funksion të zhvillimit të gjykimit konform procesit të rregullt ligjor. Në mënyrë të detajuar gjyqtarja ka pasqyruar shkaqet për disa çështje civile apo penale të cilat kanë përfunduar tej afateve ligjore të parashikuara në ligjin procedural civil apo penal, si më poshtë:

1. Në lidhje me çështjen civile me nr. 00270-372, datë regjistrimi 21.05.2019 “Caktim përfaqësuesi ligjor”, datë shorti 22.05.2019 dhe datë vendimi 12.06.2019<sup>37</sup>, gjyqtarja sqaron se e ka gjykuar brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, duke e konsideruar marrjen e çështjes efektivisht në dorë, ditën e nesërme të punës, duke e caktuar seancën e parë në datë 10.06.2019, seancë e cila është shtyrë me qëllim identifikimin e adresës së vendbanimit të debitorit për në datën 12.06.2019.

2. Në lidhje me çështjen civile me nr. 00342-418 datë regjistrimi 03.07.2019, “Caktim përfaqësuesi ligjor”, me datë shorti 03.07.2019, datë vendimi 24.07.2019<sup>38</sup>, gjyqtarja sqaron se e ka gjykuar brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, duke e konsideruar marrjen e çështjes efektivisht në dorë, ditën e nesërme të punës, duke e caktuar seancën e parë në datë 18.07.2019, seancë e cila është shtyrë me qëllim identifikimin e adresës së vendbanimit të debitorit dhe njoftimin e tij nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Pogradec, si dhe për të marrë informacionin nga sistemi Tims, informacion i cili nuk i ishte dhënë përmbartuesit gjyqësor për në datën 24.07.2019, pra vetëm pas 7 ditëve.

Për të dy çështjet si më sipër, me objekt « Caktim përfaqësuesi ligjor », neni 522 i K.Pr.C parashikon afatin ligjor 10 ditor të shqyrtimit. Të dy çështjet kanë përfunduar respektivisht 12 dhe 11 ditë tej afatit ligjor. Nëse do të konsiderohet si datë e fillimit të afatit data e shortit, rezulton se çështjet kanë përfunduar respektivisht 11 dhe 10 ditë tej afatit ligjor të gjykimit. Sa i përket shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja lidhur me faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, duke konsideruar kohën e nevojshme për kryerjen e njoftimit të debitorit, duket që ecuria procedurale e çështjeve ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej afatit ligjor, rrethanë që nuk i përjashton çështjet nga analiza matematikore, por merret parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

3. Në lidhje me 2 (dy) çështjet civile me nr. 00259-362, datë regjistrimi 17.05.2019, “Kundërshtim veprimesh përmbartimore”, datë shorti 20.05.2019, datë vendimi 25.06.2019, dhe me nr. 279-380 datë regjistrimi 28.05.2019, “Kundërshtim veprimesh përmbartimore” datë shorti 20.05.2019, datë vendimi 08.07.2019<sup>39</sup>, gjyqtarja për të dyja këto çështje sqaron se shkak për mos përfundimin e tyre në afat ka qenë kërkesa e bërë nga ana e palës në proces që relatorja e çështjes të jepte dorëheqjen nga gjykimi i çështjes pasi kishte shqyrtuar titullin ekzekutiv, në lidhje me procedurën e ekzekutimit të tij. Në këtë kontest, gjyqtarja ka paraqitur kërkesë për heqje dorë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, (për secilën nga çështjet) kërkesë e cila nuk është pranuar. Koha e kaluar nga momenti i kërkesës për dorëheqje deri në kthimin e dosjes pas refuzimit të kërkesës për dorëheqje nga kryetari i Gjykatës së Apelit Korçë, sipas gjyqtarës nuk duhet llogaritet në afatin e gjykimit të çështjes.

Në lidhje me afatin e gjykimit në çështjet me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbartimore” neni 610 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se ato shqyrtohen në dhomë këshillimi, dhe kur e vlerëson të arsyeshme, gjykata mund të thërrasë palët. Pavarësisht mënyrës së shqyrtimit, në dhomë këshillimi apo në seancë, gjykatës i duhet të kryejë disa veprime procedurale për të respektuar të drejtat e palëve në proces, duke kryer të paktën veprimet e mëposhtme:

<sup>37</sup> Çështja me numër rendor 9, tabela nr.2, kategoria « civile pa palë kundërshtare », me objekt « Emërim përfaqësuesi ligjor », për të cilën neni 522 i K.Pr.C parashikon afatin 10 ditor të shqyrtimit.

<sup>38</sup> Çështja me numër rendor 12, tabela nr.2, kategoria « civile pa palë kundërshtare », me objekt « Emërim përfaqësuesi ligjor »

<sup>39</sup> Çështjet me numër rendor 10 dhe 11, tabela nr.2, kategoria « civile pa palë kundërshtare », me objekt « Kundërshtim veprimesh përmbartimore », për të cilat neni 610 i K.Pr.C parashikon afatin 20 ditor të shqyrtimit.

- njoftimin e ankuesit për të plotësuar të metat e ankimit, nëse konstatohen të tilla dhe lënien e një afati të arsyeshëm për plotësimin e të metave, sipas parashikimeve të nenit 154/a të K.Pr.C;
- njoftimin e ankimit dhe akteve shoqëruese përmbaruesit gjyqësor dhe lënien e një afati të arsyeshëm për të paraqitur aktet e dosjes përmbarimore (*nëse ato nuk janë paraqitur të plota nga ankuesi*) dhe për të parashtruar qëndrimin e tij lidhur me ankimin;
- caktimin e seancës dhe njoftimin e palëve për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit, duke respektuar një afat minimal për të mundësuar kryerjen e njoftimit prej 5 ditësh para seancës, nëse çështja do të shqyrtohet duke thirrur palët për t'u dëgjuar.

Vetëm me kryerjen e këtyre veprimeve minimale dhe të domosdoshme për të respektuar të drejtat e palëve në proces si dhe për të mundësuar kryerjen e hetimit të plotë dhe gjithanshëm lidhur me çështjen, pa përlogaritur kohën e nevojshme për dërgimin e njoftimeve për plotësimin e të metave të padisë dhe për dërgimin e njoftimit për përmbaruesin gjyqësor për paraqitjen e prapësimeve dhe provave, afati ligjor 20 ditor i gjykimit do të rezultonte i tejkaluar. Ndërkohë që ligjvënësi, ndërsa për gjykatën e shkallës së parë që shqyrton ankimin në themel ka parashikuar afatin 20 ditor të shqyrtimit, për gjykatën e apelit që shqyrton ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mbi shkaqet e ankimit dhe kryesisht duke u bazuar në aktet e dosjes, ka parashikuar në nenin 610 një afat më të gjatë gjykimi prej 30 ditësh ose 45 ditësh, në rast se gjykata vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes me praninë e palëve, kur janë rastet e parashikuara nga ligji. Nëse për gjykimin në shkallë të parë do të zbatohet i njëjti afat, pra afati 30 ditë për shqyrtimin në dhomë këshillimi dhe 45 ditë për shqyrtimin në seancë, rezulton se për të dy çështjet afati i përfundimit të gjykimit nuk do të ishte tejkaluar pasi çështjet kanë përfunduar respektivisht për 39 dhe 41 ditë. ***Për këto arsye, këto dy çështje duhet të përlogariten si çështje që janë gjykuar brenda afatit ligjor.***

4. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Miratim marrëveshje”, nr. 00620-480 regj. them datë 08.11.2019<sup>40</sup>, rezulton se është shqyrtuar për 32 ditë, gjyqtarja jep këtë shpjegim:” *Nga ana e organit të akuzës kjo kërkesë ishte dërguar në lidhje me miratimin e marrëveshjeve për secilin prej dy të pandehurve që rezultonin në procedimin penal. Nga ana ime është caktuar data e seancës gjyqësore dhe konkretisht data 02.12.2019 me qëllim që të njoftoheshin të pandehurit. Në seancën e datës 02.12.2019 njëri prej të pandehurve nuk kishte marrë dijeni dhe duke mbajtur në vëmendje kryerjen e një njoftimi efektiv, kam urdhëruar njoftimin e tij me anë të Komisarariatit të Policisë Pogradec, duke ju lënë një afat 7 ditor, për në datë 10.12.2019. Për këto arsye në lidhje me këtë dosje edhe në referim të nenit 399/2/3, dhe konkretisht duke u mbajtur në vëmendje i) shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim”, si dhe për të respektuar procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e të pandehurit në procesin penal, duhet të mos llogariten në afatin e përgjithshëm të gjykimit, duke zbritur kohëzgjatjen nga data 02.12.2019 deri në datën 10.12.2019, afati i përgjithshëm rezulton më pak se 30 ditë, sipas nenit 406/dh e vijues të K.Pr.Penale.*

Referuar shpjegimeve të dhëna nga gjyqtarja konstatohet se seanca e parë gjyqësore është caktuar në një afat kohor prej 24 ditësh nga data e caktimit të çështjes me short, pra në limitet e afatit 30 ditor të parashikuar në ligj për përfundimin e çështjes. Në këtë kontekst, vlerësohet se gjyqtarja duhet të kishte marrë masa për planifikimin e seancës së parë gjyqësore në një kohë më të shkurtër, për të mundësuar zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit brenda afatit

<sup>40</sup> Çështja me numër rendor 10, tabela nr.8, kategoria « penale krime », me objekt « miratim marrëveshje », për të cilën neni 406/dh, pika 2 i K.Pr.P parashikon afatin 30 ditor të shqyrtimit.

ligjor. Gjithsesi, shkak i bërë prezent prej saj, për njoftimin efektiv të njërit prej të pandehurve, përbën shkak të arsyeshëm që lidhet me respektimin e parimit të procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst konsiderohet edhe fakti që tejkalimi i afatit ligjor në këtë rast rezulton të jetë vetëm me 2 ditë, i cili vlerësohet i pa konsiderueshëm. ***Për këto arsye, kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

5. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Miratim marrëveshje”, nr. 00609-470 regj.them datë 04.11.2019<sup>41</sup>, gjyqtarja sqaron se: “Kjo çështje është caktuar pranë meje me shortin e datës 06.11.2019 rezulton se është shqyrtuar për 35 ditë jap këtë shpjegim: Seanca gjyqësore është caktuar në datë 18.11.2019 dhe në këtë seancë më rezultoi se nuk ishte paraqitur prokurori dhe nuk ishte paraqitur i pandehuri. Nga prezenca e avokatit në seancë më rezultoi se i pandehuri ndodhej jashtë shtetit. Me qëllim për të gjykuar brenda afatit ligjor kam caktuar seancë për në datë 02.12.2019, seancë në të cilën u paraqit i pandehuri ndërkohë viktima nga vepra penale nuk ishte paraqitur pasi nuk kishte dijeni të rregullt. Seanca e ardhshme u caktua në datë 11.12.2019 seancë në të cilën u shqyrtua marrëveshja. Për këto arsye në lidhje me këtë dosje në referim të nenit 399/2/3, dhe konkretisht duke u mbajtur në vëmendje i) shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim”, si dhe për të respektuar procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat e të pandehurit në procesin penal, si dhe të viktimit nga vepra penale, duhet të mos llogariten në afatin e përgjithshëm të gjykimit, duke zbritur kohëzgjatjen nga data 18.11.2019 deri në datën 11.12.2019, afati i përgjithshëm rezulton më pak se 30 ditë, sipas nenit 406/dh e vijues të K.Pr.Penale.”

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtarës për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 406/dh, pg 2 i K.Pr.Penale, për shkak të rrethanave objektive të procedimit (njoftimin dhe garantimin e së drejtës së palëve për të marrë pjesë në gjykim) vlerësohen si rrethana objektive duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se gjyqtarja ka planifikuar brenda afateve të shkurtra kohore, si seancën e parë gjyqësore (14 ditë pas regjistrimit të saj), ashtu edhe seancat pasardhëse, si dhe ka marrë masa efektive për realizimin e njoftimit të palëve. Në këtë kontekst, vlerësohet që kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje e gjykuar brenda afatit ligjor, i cili rezulton i tejkualuar vetëm me 5 ditë.

6. Në lidhje me kërkesën penale “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit”, nr.00195-169 regj.them datë 26.04.2019<sup>42</sup>, gjyqtarja sqaron se: “Kjo çështje është caktuar pranë meje me shortin e datës 26.04.2019, rezulton se është shqyrtuar për 41 ditë duke tejkualuar afatin ligjor me 11 ditë jap këtë shpjegim; Kam caktuar seancën në datë 15.05.2019 dhe gjatë debatit gjyqësor ankuesi ngriti pretendime në lidhje me një vendim civil për të cilin po me këtë kërkues kisha gjykuar një çështje më parë. Me qëllim për një proces të rregullt ligjor kam shtyrë seancën gjyqësore dhe i kam kërkuar për seancën e ardhshme vendimet gjyqësore të pretenduar. Në seancën e datës 21.05.2019 pala kërkuese ka paraqitur disa prova dhe kam shtyrë çështjen për konkluzione përfundimtare. Në seancën e datës 23.05.2019 vlerësova që për një proces të rregullt ligjor ti drejtohem me kërkesë heqje dorë Kryetares së Apelit Korçë në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, kjo rezultuar nga provat e paraqitura në seancën e datës 21.05.2019 dhe konkretisht me arsyetimin se:”... Në lidhje me këtë kërkues me

<sup>41</sup> Çështja me numër rendor 11, tabela nr.8, kategoria « penale krime », me objekt « Miratim marrëveshje », për të cilën neni 406/dh, pika 2 i K.Pr.P parashikon afatin 30 ditor të shqyrtimit.

<sup>42</sup> Çështja me numër rendor 1 ose 69, tabela nr.10, kategoria « kërkesa penale të hetimit paraprak », me objekt « Ankim ndaj vendimit të mosfillimit », për të cilën neni 291, pika 3 i K.Pr.P parashikon afatin 30 ditor të shqyrtimit.

vendimin Nr. (600)- 217 datë 02.07.2018 kam marrë në gjykim kërkesën penale me objekt "Kundërshtimi i vendimit të mosfillimit të procedimit penal", që u përket të njëjtëve kërkuar dhe në përfundim të atij gjykimi kam vendosur:" Pranimin e ankimit. Urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal në lidhje me veprën për të cilën është referuar "Ekspertim i rreme" i parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. Kundër këtij vendimi palët mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit Korçë brenda 10 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.", dhe në dosje gjeni vendimin e printuar nga sistemi. Në seancat e datës 15.05.2019 dhe 21.05.2019 nga ana e kërkuarit mu pretendua disa herë kjo vendimmarrje e imja duke e dhënë si argument. Në këto kushte duke qenë se ndodhem para përcaktimeve të nenit 17/1 pika "c" dhe "ë" i K.Pr.Penale, me përmbajtje "Gjyqtari ka detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete ...c) kur ka dhënë këshilla ose ka kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit...ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera njëanshmërie...", unë si gjyqtare që kam shqyrtuar një kërkesë të palëve në lidhje me grup faktet e vëna në themel të këtyre dy kërkesave, për pasurinë 14/15 ZK 3665 vol.11, fq. 3 Hudenisht, po ju kërkoj pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi". Gjykata e Apelit me vendimin e datës 27.05.2019 ka vendosur mospranimin e kërkesës për heqje dorë dhe në datë 30.05.2019 dosja është paraqitur në gjykatë dhe kam njoftuar kërkuar dhe prokurorin në lidhje me vijimin e gjykimit aty ku kishte mbetur duke dhënë vendim në datë 06.06.2019. Për sa më sipër vlerësoj se mosrespektimi i këtij afati nuk ka ndodhur për moskorrektësi apo përgjegjshmëri por me qëllim respektimin e procesit të rregullt ligjor dhe respektimit të të drejtave të palëve në gjykim."

Në lidhje me argumentet e parashtruara nga ana e gjyqtares, vlerësoj se shkaqet që kanë ndikuar në ecurinë e procedimit dhe përfundimin e tij në tejkalim të afatit ligjor janë shkaqe të përligjura dhe që nuk ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtaren, pasi lidhen me shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Pavarësisht shkaqeve, rezulton se afati ligjor i përfundimit të gjykimit është tejkaluar me vetëm 11 ditë. **Për sa më sipër, kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.**

7. Në lidhje me çështjen penale me objekt "Dërgim çështje në gjykim", nr. 28/00471-458 regj.them datë 21.12.2018<sup>43</sup>, rezulton se është shqyrtuar për 144 ditë dhe gjyqtarja jep këtë shpjegim : "Rezultoi që kjo çështje është sjellë për kompetencë nga Gjykata për Krime të Rënda Shkallë e Parë Tiranë, me të pandehur një shtetase të huaj. Në kushtet kur kishte adresë të saktë kam caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 10.01.2019, duke e njoftuar me fletëthirrje por ndërkohë që nuk morri dijeni të rregullt. Në këto kushte me anë të Ministrisë së Drejtësisë kam dërguar dy njoftime në lidhje me këtë shtetase dhe sipas afateve minimale kohore që nevojitet për njoftimin me anë të Ministrisë së Drejtësisë autoriteteve gjyqësore në shtetin e Maqedonisë së Veriut isha në pamundësi efektive për të gjykuar këtë çështje brenda afatit 30 ditor. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë kapërcyer për shkak të rrethanave të pamundësisë objektive për procedim në referim të nenit 399/2/3, të K.Pr.Civile".

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale për shkak të rrethanave objektive të procedimit (njoftimit në mënyrë efektive të pandehurit në proces që për shkak të njoftimit të tij me letër porosi kërkohet një kohë relativisht e gjatë) vlerësohen të drejta dhe objektive. Në këtë

---

<sup>43</sup> Çështja me numër rendor 21, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq », për të cilën neni 332, pika 3 i K.Pr.P parashikon afatin 30 ditor të shqyrtimit.

kontekst, kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor, duke i marrë të mirëqena shpjegimet e dhëna nga ana e gjyqtares dhe ***kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

8. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00259-201 regj. them datë 29.05.2019<sup>44</sup>, rezulton se është shqyrtuar për 43 ditë nga data e caktimit me short, gjyqtarja jep këtë shpjegim; “*Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 10.06.2019 dhe i pandehuri nuk është njoftuar në adresën e sjellë nga organi procedues. Kam marrë vendim në lidhje me njoftimin e të pandehurit me anë të Drejtorisë Vendore Durrës, Komisarariatit të Policisë duke e shtyrë seancën për në datë 25.06.2019, datë në të cilën nuk ka ardhur asnjë konfirmim në lidhje me këtë të pandehur. Për këtë arsye seanca u caktua në datë 10.07.2019 seancë në të cilën rezultoi se i pandehuri ishte njoftuar dhe për këtë arsye gjykata vijoi gjykimin në mungesë të tij dhe në prani të mbrojtësit duke dhënë vendim. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë tejkaluar me 13 ditë për shkak të respektimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal dhe në referim të nenit 399/2/3, duke u mbajtur në vëmendje se janë kapërcyer për shkak të rrethanave të pamundësisë objektive për procedim”.*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale për shkak të rrethanave objektive të procedimit (*njoftimit në mënyrë efektive të palëve në proces*) vlerësohen të drejta dhe objektive duke mbajtur këtu në konsideratë edhe faktin se gjyqtarja ka menaxhuar dhe planifikuar brenda afateve të shkurtra si seancën e parë gjyqësore (*10 ditë pas regjistrimit të saj konform nenit 332/2 të K.Pr.Penale*) ashtu edhe seancat pasardhëse me qëllim njoftimin e palëve (*jo më shumë se 15 ditë konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale*). Sa i përket shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja lidhur me faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, duke konsideruar kohën e nevojshme për njoftimin efektiv të palëve, duket që ecuria procedurale e çështjeve ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej afatit ligjor, rrethanë që nuk e përjashton çështjet nga analiza matematikore, por merret parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

9. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00454-370 regj. them datë 24.07.2019<sup>45</sup>, rezulton se është shqyrtuar për 48 ditë gjyqtarja sqaron se: “*Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 10.09.2019 menjëherë pas lejes vjetore dhe në rast se nuk do merrej parasysh kohëzgjatja e saj atëherë kjo çështje është shqyrtuar brenda afateve ligjore. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë tejkaluar me 18 ditë për shkak të lejes vjetore të vitit 2019.*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale për shkak të rrethanave objektive (*leja vjetore*) vlerësohen të drejta dhe objektive, duke mbajtur këtu në konsideratë faktin se çështja është regjistruar në gjykatë 6 ditë para marrjes së lejes vjetore. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit do të zbritej periudha e lejes vjetore në muajin gusht, atëherë çështja do të kishte përfunduar

---

<sup>44</sup> Çështja me numër rendor 50, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq ».

<sup>45</sup> Çështja me numër rendor 51, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq »

brenda afatit ligjor. ***Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsiderate sa më sipër, kjo çështje duhet të përllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

10. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr.00461-377 regj.them datë 26.07.2019<sup>46</sup>, rezulton se është shqyrtuar për 46 ditë gjyqtarja sqaron se: *“Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 10.09.2019 menjëherë pas lejes vjetore dhe në rast se nuk do merrej parasysh kohëzgjatja e saj atëherë kjo çështje është shqyrtuar brenda afateve ligjore. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë tejkualuar me 16 ditë për shkak të lejes vjetore të vitit 2019.”*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale për shkak të rrethanave objektive (*leja vjetore*) vlerësohen të drejta dhe objektive duke mbajtur këtu në konsideratë edhe faktin se çështja është e regjistruar 4 ditë para marrjes së lejes vjetore. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit do të zbritej periudha e lejes vjetore në muajin gusht, atëherë çështja do të kishte përfunduar brenda afatit ligjor. ***Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsiderate sa më sipër, kjo çështje duhet të përllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

11. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00472-386 regj.them datë 31.07.2019<sup>47</sup>, shortuar në datë 02.09.2019 rezulton se është shqyrtuar për 63 ditë gjyqtarja sqaron se: *“Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 17.09.2019 menjëherë pas lejes vjetore dhe e pandehura nuk kishte marrë dijeni duke shtyrë seancën për në datë 02.10.2019 datë në të cilën u gjykua. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje nuk rezultojnë të jenë tejkualuar nga unë si gjyqtare pasi e kam përfunduar çështjen brenda afatit ligjor duke mbajtur në vëmendje datën 02.09.2019 kur më ka kaluar në short.”*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale për shkak të rrethanave objektive (*caktimin e çështjes me short në datë 02.09.2019 për shkak të lejes vjetore në muajin gusht*) vlerësohen të drejta dhe objektive duke mbajtur këtu në konsideratë edhe faktin se çështja ka përfunduar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nëse do të konsiderohej data e shortit 02.09.2019 si datë fillimi, në kushtet kur çështja është regjistruar ditën e fundit të punës të muajit korrik para marrjes së lejes vjetore. ***Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, kjo çështje duhet të përllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

12. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00499-403 regj.them datë 11.09.2019<sup>48</sup>, shortuar në datë 18.09.2019 rezulton se është shqyrtuar për 36 ditë, gjyqtarja sqaron se: *“Çështja më është shortuar në datë 18.09.2019 dhe kam dhënë vendim në datë 17.10.2019, duke e përfunduar çështjen brenda afatit ligjor.”*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtares për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 332/3 i K.P.Penale, duke mbajtur në konsideratë faktin që gjyqtarja është caktuar si relatores e kësaj çështje me shortin e datës 18.09.2019 dhe çështja është

---

<sup>46</sup> Çështja me numër rendor 52, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq »

<sup>47</sup> Çështja me numër rendor 57, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq »

<sup>48</sup> Çështja me numër rendor 60, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq ».

përfunduar brenda afatit 30 ditor duke u nisur nga kjo datë. ***Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, kjo çështje duhet të përlllogaritet si çështje që është gjykuar brenda afatit ligjor.***

13. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00473-387 regj.them datë 31.07.2019<sup>49</sup>, shortuar në datë 04.09.2019 rezulton se është shqyrtuar për 47 ditë gjyqtarja sqaron se “..Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 19.09.2019 por për shkak të angazhimeve-seminar jashtë vendit kam qenë në pamundësi objektive për ta zhvilluar seancën. Në seancën e datës 30.09.2019 e pandehura nuk ishte njoftuar dhe kam kryer njoftimin e saj me anë të Komisarariatit të Policisë Drejtoria Vendore Durrës, po kështu në seancën e datës 15.10.2019 nuk ishte arritur të njoftohej e pandehura dhe viktima nga vepra penale nëpërmjet Komisarariatit të Policisë përkatësisht Durrës dhe Pogradec dhe për këtë shkak është shtyrë seanca për në datë 21.10.2019 datë në të cilën u dha vendimi. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë tejkualuar me 17 ditë për shkak të lejes vjetore të vitit 2019 edhe në referim të nenit 399/2/3, dhe konkretisht duke u mbajtur në vëmendje i) janë kapërcyer për shkak të rrethanave të pamundësisë objektive për procedim”.

Duke konsideruar shortimin e çështjes në datë 04.09.2019, për shkak të paraqitjes së saj në ditën e fundit të punës, para pushimeve vjetore të muajit gusht, kohëzgjatja e gjykimit, pavarësisht shkaqeve që kanë ndikuar në këtë kohëzgjatje (shtyrja e seancës së parë për të mundësuar njoftimin e të pandehurit) rezulton të jetë 47 ditë, duke tejkualuar afatin ligjor me 17 ditë. Referua shpjegimeve të gjyqtarës lidhur me ecurinë e gjykimit, konstatohet se planifikimi i seancës së parë gjyqësore është bërë tej afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 332/2 të K.Pr.Penale (seanca e parë është lënë në një afat për 15 ditë pra tej afatit 10 ditor). Po ashtu angazhimi i saj në aktivitete trajnuese nuk mund të konsiderohet si shkak i përligjur për kohëzgjatjen e gjykimeve, pasi gjyqtari ka mundësi që të planifikojë seancat gjyqësore në mënyrë efektive, duke konsideruar angazhimet e tjera profesionale të cilat, si rregull, planifikohen dhe njoftohen disa ditë para zhvillimit të tyre. Sa i përket shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja lidhur me faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, duke konsideruar duket që ecuria procedurale e çështjeve ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej afatit ligjor, rrethanë që nuk i përjashton çështjet nga analiza matematikore, por merret parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

14. Në lidhje me çështjen penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”, nr. 00527-419 regj.them datë 26.09.2019<sup>50</sup>, datë shorti 27.09.2019 rezulton se është shqyrtuar për 48 ditë, gjyqtarja sqaron se: “Seancën e parë gjyqësore e kam caktuar në datë 07.10.2019 dhe i pandehuri nuk ishte njoftuar dhe kam kryer njoftimin e tij me anë të Komisarariatit të Policisë Drejtoria Vendore Durrës, po kështu në seancat e datës 22.10.2019 dhe datës 31.10.2019 nuk ishte arritur të njoftohej i pandehuri nga Komisarati i Policisë Durrës dhe për këtë arsye u shty për në datë 13.11.2019 datë në të cilën u dha vendimi dhe i pandehuri u paraqit personalisht. Për këto arsye afatet në lidhje me këtë dosje janë tejkualuar me 18 ditë për shkak të lejes vjetore të vitit 2019 edhe në referim të nenit 399/2/3, dhe konkretisht duke u mbajtur

---

<sup>49</sup> Çështja me numër rendor 61, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq ».

<sup>50</sup> Çështja me numër rendor 62, tabela nr.10, kategoria « penale seancë paraprake », me objekt « Dërgimin e çështjes në gjyq ».



*në vëmendje i) janë kapërcyer për shkak të rrethanave të pamundësisë objektive për procedim”.*

Argumentet e dhëna nga ana e gjyqtarës për përfundimin e çështjes jashtë afatit 30 ditor të parashikuar në ligj, duken që lidhen me ecurinë procedurale të çështjes, rrethanë që nuk i përjashton çështjet nga analiza matematikore, por merret parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

*Sa më sipër*, numri i çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit, pas analizës logjike si më sipër, bazuar në tregues objektive që rezultojnë nga tabelat me të dhëna statistikore si dhe shpjegimeve të pasqyruara në formularin e integruar, rezulton të jetë 15 çështje të gjykuara jashtë afatit ligjor. Duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (15 çështje) me numrin e çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (138 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 10.9 (10.86... ) % të çështjeve tej afatit ligjor.

## **KONKLUZIONE:**

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Duke konsideruar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, pas analizës logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton të jetë 10.9 %. Pavarësisht përqindjes, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me një shkallë me të lartë për këtë tregues duke konsideruar:

- (i) tejkalimin me vetëm 0.9 % të përqindjes që përkon me pikëzimin maksimal ;
- (ii) numrin e konsiderueshëm të çështjeve me afat ligjor në raport me numrin total të çështjeve (138 çështje nga 367 çështje të përfunduara në total ose rreth 38 % e numrit total të çështjeve të gjykuara kanë qenë me afat ligjor) ;
- (iii) tejkalimin e afatit ligjor të gjykimit për 15 çështjet me vetëm disa ditë.

Referuar ngarkesës së gjyqtarës (*në total ka gjykuar 367 çështje dhe i janë caktuar gjithsej 468 çështje*), shpjegimeve të dhëna prej saj lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, dhe pas analizës tërësore të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se gjyqtarja në përgjithësi i ka kushtuar rëndësi përfundimit të çështjeve brenda afateve të përcaktuara në ligj.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 10.9 %, duke tejkaluar me vetëm 0.9 %, përqindjen që përkon me nivelin maksimal të pikëzimit.*

### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se:*** Gjyqtarja subjekt vlerësimi, ka gjykuar në total 229 çështje për të cilat parashikohet standard minimal kohor (pa përfshirë këtu çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore gjykimi), nga të cilat:

- (i) 28 (njëzet e tetë) çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” nga të cilat konstatohet se **16 (gjashtëmbëdhjetë) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard** minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (ii) 53 (pesëdhjetë e tre) çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”<sup>51</sup> nga të cilat konstatohet se **7 (shtatë) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard** minimal kohor prej 2 (dy) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (iii) 24 (njëzet e katër) çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”<sup>52</sup> nga të cilat konstatohet se **15 (pesëmbëdhjetë) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard** minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (iv) 7 (shtatë) çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, nga të cilat konstatohet se **3 (tre) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard** minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (v) 3 (tre) çështje civile të kategorisë “*marrëdhënie pune*” të cilat konstatohet se kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (vi) 35 (tridhjetë e pesë) çështje të kategorisë “*penale krime*” të cilat konstatohet se kanë përfunduar brenda afatit standard minimal kohor prej 9 dhe 12 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (vii) 32 (tridhjetë e dy) çështje të kategorisë “*penale kundërvajtje penale*” nga të cilat konstatohet se **9 (nëntë) prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit standard** minimal kohor prej 4 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së.
- (viii) 37 (tridhjetë e shtatë) çështje të kategorisë “*pushim procedimi penal*” nga të cilat konstatohet se **12 (dymbëdhjetë) prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit standard** minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261 të ish KLD-së.
- (ix) 10 (dhjetë) çështje të kategorisë “*penale në fazën e ekzekutimit*” nga të cilat konstatohet se **3 (tre) prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit standard** minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261 të ish KLD-së.

Në total nga 229 (dyqind e njëzet e nëntë) çështje për të cilat parashikohet standard minimal kohor, referuar të dhënave statistikore dhe analizës matematikore, rezulton se gjyqtarja {...} ka gjykuar 65 (gjashtëdhjetë e pesë) çështje ose 28.3 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor.

***Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit***, ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me ngarkesën e lartë, dhe rrethanat objektive në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjyqtarja në

<sup>51</sup>Duke zbritur 9 çështjet me afat ligjor në këtë tabelë

<sup>52</sup>Duke zbritur 6 çështjet me afat ligjor në këtë tabelë.

mënyrë të detajuar ka shpjeguar shkaqet e mbarimit të afateve standarde për disa prej tyre, duke vlerësuar në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

1. Me ndryshimet e K.Pr.Civile në nenin 399 e vijues të K.Pr.Civile janë parashikuar tashmë afatet e arsyeshme për gjykimin e çështjeve civile apo penale dhe pothuajse në çdo rast gjyqtarja pretendon se nuk i ka kaluar afatet e parashikuara në to. Në vijim argumenton se nuk duhet të merren parasysh afatet e kaluara sipas nenit 399/2 pika "3" të K.Pr.Civile sipas së cilës: (i) nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, (ii) kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu (iii) kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.
2. Nuk duhet të merren parasysh afatet e parashikuara në ligjin procedural civil në lidhje me njoftimin e padisë dhe akteve për një afat 30 ditor, njoftimin e deklaratës së mbrojtjes së bashku me datën e seancës së parë gjyqësore po ashtu me një afat 30 ditor, afati 20 ditë i parashikuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile për shpalljen e arsyetuar të vendimit, afatin 20 ditë për njoftimet e palëve ndërgjyqëse me shpallje konform nenit 133 të K.Pr.Civile, afatin 5 ditë të parashikuar në nenin 302 të K.Pr.Civile për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve në proces.
3. Nuk duhet të merren parasysh afatet që ecin jo për faj të gjykatës si afati 35 ditë i lejes vjetore, afati i ankimit nga ana e palëve të vendimeve të ndërmjetme (si ajo e fazës së parë të pjesëtimit), afati i ankimit të pezullimit të çështjes, apo kur çështja është bërë konflikt kompetence në gjykatë të lartë etj. Po kështu gjyqtarja ka argumentuar në disa raste se afati i gjykimit duhet të fillojë nga momenti caktimit të saj si relatores e çështjes në ato raste kur gjyqtarët e mëparshëm kanë dhënë dorëheqje nga çështja konkrete.
3. Gjithashtu sipas gjyqtarës duhet të mbahet në vëmendje edhe kompleksiteti i çështjes, njoftimet në mënyrë efektive të palëve, pamundësitë objektive megjithë masat e marra për realizimin e njoftimeve për të pandehurit apo palët ndërgjyqëse në funksion të zhvillimit dhe të respektimit të një procesi të rregullt ligjor, numri i madh i palëve në proces, angazhimet profesionale, etj.

**Pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës në lidhje me përfundimin e disa prej çështjeve jashtë standardit minimal kohor analizohen në vijim në tërësinë e tyre duke vlerësuar se vetëm në disa prej tyre argumentet e gjyqtarës lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, gjejnë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve.**

- Standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orjentuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjykimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuarin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

- Afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së.

- Afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standard orientues të gjykimit të çështjes. Standardet orjentuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si : shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit ; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.
- Afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (si p.sh. afati 35 ditë në muajin Gusht - leja vjetore) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mire të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate në çështjet e referuara nga ana e gjyqtarës në formularin e integruar nuk duhet të llogariten. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarës si relatore e çështjes në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë.

Në tërësi duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar mbi pretendimet e parashtruara nga ana e gjyqtarës, për çdo çështje të referuar në formularin e integruar, dhe duke i marrë të mirëqena shpjegimet e gjyqtarës, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor edhe 8 çështje të tjera, më konkretisht:

- Çështja civile me nr. 77/00363-459 datë regjistrimi 19.07.2018 e cila është gjykuar për 209 ditë, pasi pretendimi në lidhje me mospërfshirjen në kohëzgjatjen e çështjes të lejes vjetore prej 35 ditë, është i drejtë dhe në këtë kontekst kjo çështje do të konsiderohet në afat, 174 ditë (5 muaj e 24 ditë) duke zbritur periudhën prej 35 ditësh të lejes vjetore në muajin Gusht.
- Çështja civile me nr. 46/00130-307 datë regjistrimi 16.03.2018 e cila është gjykuar për 362 ditë, pasi çështja është paraqitur me short përpara gjyqtarës në datën 03.12.2018 (pas dorëheqjes së gjyqtarit të mëparshëm) dhe afati i gjykimit nga ana e saj rezulton të jetë 100 ditë ( 3 muaj e 10 ditë), pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.
- Çështja civile me nr. 106/00470-532 datë regjistrimi 04.10.2018 gjykuar për 265 ditë, pasi periudha nga data 31.01.2019 deri në datën 26.06.2019 duhet të mos llogaritet duke qenë se është koha e kaluar nga momenti i parashtrimit të konfliktit të kompetencës në gjykatën e lartë nga ana e gjyqtarës deri në mbërritjen e dosjes në gjykatë. Duke zbritur kohën gjatë se cilës çështja është shqyrtuar për efekt të konfliktit të kompetencës, rezulton se gjykimi ka përfunduar për 216 ditë (7 muaj e 2 ditë). Duke i zbritur kësaj periudhë kohën e lejes vjetore në muajin gusht prej 35 ditësh, çështja rezulton të jetë shqyrtuar për 181 ditë (6 muaj e 1 ditë), brenda standardit minimal kohor.
- Çështja civile me nr. 101/00449-520 datë regjistrimi 26.09.2018, gjykuar për 385 ditë, pasi nuk duhet të llogaritet koha nga data e marrjes së vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit deri në rifillimin e saj, duke e konsideruar çështjen të gjykuar brenda afatit standard.
- 9 (nëntë) çështjet kundërvajtje penale, dhe 3 (tre) çështjet e kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, referuar shpjegimeve të dhëna nga ana e gjyqtarës lidhur me shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit (*njoftimin e palëve, mungesa disa*

*herë e organit të akuzës, njoftimi i dëshmitarëve me gjithë masat e marra nga ana e gjykatës, mospërfshirjen e kohës së lejes vjetore në muajin Gusht, etj), vlerësoj se duhet të konsiderohen si të përfunduara brenda standardit minimal kohor vetëm 4 (katër) çështjet si më poshtë:*

- çështja me nr. 15/000398-147, me datë regjistrimi 26.10.2018, datë përfundimi 13.03.2019 e cika ka përfunduar për 125 ditë, duke tejkuluar vetëm me 5 ditë standardin minimal kohor 4/muaj ;
  - çështja me nr. 00420-150, me datë regjistrimi 18.07.2019, datë përfundimi 19.11.2019 e cika ka përfunduar për 129 ditë, duke tejkuluar vetëm me 9 ditë standardin minimal kohor 4/muaj. Duke konsideruar edhe lejen vjetore të gjykatës në muajin gusht, vlerësohet se çështja duhet të konsiderohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor ;
  - çështja me nr. 00407-146, me datë regjistrimi 10.07.2019, datë përfundimi 19.11.2019 e cika ka përfunduar për 132 ditë, duke tejkuluar vetëm me 12 ditë standardin minimal kohor 4/muaj. Duke konsideruar edhe lejen vjetore të gjykatës në muajin gusht, vlerësohet se çështja duhet të konsiderohet se ka përfunduar brenda standardit minimal kohor ;
  - çështja me nr. 00242-196, me datë regjistrimi 22.05.2019, datë përfundimi 30.07.2019 e cika ka përfunduar për 69 ditë, duke tejkuluar vetëm me 9 ditë standardin minimal kohor 2/muaj.
- (vi) Në lidhje me 4 (katër) çështje civile tek tabela nr. 2, për të cilat gjyqtarja ka dhënë shpjegime mbi shkaqet e përfundimit të tyre jashtë afatit ligjor,<sup>53</sup> duke qenë se për to parashikohet afat ligjor dhe jo standard minimal kohor janë analizuar dhe vlerësuar tek kriteri i respektimit të afateve ligjore.
- (vii) Për dy çështjet penale tek tabela nr.8 me objekt miratim marrëveshje me nr. 00620-480 datë 08.11.2019 regj.them dhe çështja nr. 00609-470 datë 04.11.2019 regj.them, janë çështje për të cilat parashikohet afat ligjor, e në këtë kontekst janë analizuar tek kriteri i respektimit të afateve ligjore për përfundimin e çështjeve.
- (viii) Në lidhje me kërkesën penale “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit”, nr. 00195-169 datë 26.04.2019 regj.them, analiza në lidhje me pretendimet e gjyqtares është bërë tek kriteri i respektimit të afateve ligjore për përfundimin e çështjes, duke qenë se për këtë kategori çështjeje parashikohet afat ligjor dhe jo standard minimal kohor. Në lidhje me 8 (tetë) çështjet penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”<sup>54</sup>, analiza në lidhje me pretendimet e gjyqtares është bërë tek kriteri i respektimit të afateve ligjore për përfundimin e çështjes duke qenë se për këto çështje parashikohen afate ligjore për përfundimin e tyre dhe jo standard minimal kohor.
- (ix) Në lidhje me 8 (tetë) çështjet penale me objekt “Dërgim çështje në gjykim”<sup>55</sup>, analiza në lidhje me pretendimet e gjyqtares është bërë tek kriteri i respektimit të afateve ligjore për përfundimin e çështjes duke qenë se për këto çështje parashikohen afate ligjore për përfundimin e tyre dhe jo standard minimal kohor.

---

<sup>53</sup> Çështja civile me nr. 00270-372 datë regjistrimi 21.05.2019, “Caktim përfaqësuesi ligjor” datë vendimi 12.06.2019, çështjen nr. 00342-418 regj.them datë regjistrimi 03.07.2019, “Caktim përfaqësuesi ligjor” datë vendimi 24.07.201, çështjen civile me nr. 00259-362 regj.them datë regjistrimi 17.05.2019, “Kundërshtim veprimesh përmbarmore” datë vendimi 25.06.2019, dhe çështjen civile me nr. 279-380 datë regjistrimi 28.05.2019, “Kundërshtim veprimesh përmbarmore” datë vendimi 08.07.2019.

<sup>54</sup> Çështjet me nr. 28/00471-458 regj.them datë 21.12.2018, - nr. 00259-201 regj.them datë 29.05.2019, - nr. 00454-370 regj.them datë 24.07.2019.2019,- nr. 00461-377 regj.them datë 26.07.2019.2019, -nr. 00472-386 regj.them datë 31.07.2019, - nr. 00499-403 regj.them datë 11.09.2019, - nr. 00473-387 regj.them datë 31.07.2019, - nr. 00527-419 regj.them datë 26.09.2019

<sup>55</sup> Çështjet me nr. 28/00471-458 regj.them datë 21.12.2018, - nr. 00259-201 regj.them datë 29.05.2019, - nr. 00454-370 regj.them datë 24.07.2019.2019,- nr. 00461-377 regj.them datë 26.07.2019.2019, -nr. 00472-386 regj.them datë 31.07.2019, - nr. 00499-403 regj.them datë 11.09.2019, - nr. 00473-387 regj.them datë 31.07.2019, - nr. 00527-419 regj.them datë 26.09.2019

Për çështjet e tjera të cilave gjyqtarja i referohet në vetëvlerësimin e saj në lidhje me këtë tregues, nuk mund të konsiderohen si çështje të përfunduara në afat, pasi standardi minimal kohor për to rezulton të jetë tejkaluar nga 13 ditë minimalisht deri në 113 ditë dhe për shumicën prej tyre, në kohëzgjatjen e gjykimit nuk është përfshirë muaji gusht.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor rezulton të jetë 57 çështje, ose 24.8 %. Kjo përqindje përkon me pikëzimin me 3 pikë. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarës. Gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 367 çështje nga të cilat 181 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme, familjare, marrëdhënie pune, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi*). Referuar standardit sasior në fuqi<sup>56</sup>, gjyqtarja duhet të përfundonte jo më pak se 80 çështje me palë kundërshtare në vit<sup>57</sup>. Ndërkohë rezulton se ajo ka përfunduar 181 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar këtë standard me 101 çështje në vit ose në masën 126 %. Nga ana tjetër gjyqtarja ka gjykuar edhe 186 çështje të tjera pa palë kundërshtare dhe dërgimin çështjen e gjyq.

## **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me : (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve që rezulton 24.8 % ; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit referuar shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 126 %, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 24.8 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (tejkalim i standardit sasior me 126%).*

<sup>56</sup> Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, t ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se "Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare.". Në pikën

<sup>57</sup> Në këtë llogaritje mbahet parasysh fakti që si drejtuese e gjykatës, standardi minimal sasior orientues për të ishte në masën 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate, që përkon me treguesin sasior jo më pak se 80 çështje me palë kundërshtare.

## ***2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik,*** rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategori, rezulton si më poshtë:

- (i) Në çështjet e kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”* koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 264.1 ditë (8 muaj e 24 ditë), pra **më e gjatë** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh ;
- (ii) Në çështjet e kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 24.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (iii) Në çështjet e kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 146.1 ditë (4 muaj e 26 ditë), pra **më e gjatë** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 (katër) muajsh;
- (iv) Në çështjet e kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 24.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (v) Në çështjet e kategorisë *“marrëdhënie pune”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 162.3 ditë (5 muaj e 12 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 6 (gjashtë) muajsh;
- (vi) Në çështjet e kategorisë *“penale krime”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 78.6 ditë (2 muaj e 18 ditë) pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 9 (nëntë) ose 12 (dymbëdhjetë) muajsh;
- (vii) Në çështjet e kategorisë *“penale kundërvajtje”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 100.3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 4 (katër) muajsh;
- (viii) Në çështjet e kategorisë *“seancë paraprake”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 47.8 ditë ( 1 muaj e 17 ditë), pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;
- (ix) Në çështjet e kategorisë *“kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton të jetë 43 ditë (1 muaj e 13 ditë) , pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muajsh;

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar shumë të lartë aftësinë e saj lidhur me këtë tregues, duke argumentuar se është përpjekur maksimalisht të respektojë afatet standarde në gjykimin e çështjeve, por duke u kujdesur që kjo të mos cenojë të drejtat e palëve në proces, kontradiktoritetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, cilësinë e gjykimit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor. Po ashtu gjyqtarja ka kërkuar që për vlerësimin e këtij treguesi të konsiderohet ngarkesa e lartë e përballuar prej saj si dhe ngarkesa me funksionet administrative të drejtimit të gjykatës.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit<sup>58</sup>. Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 9 kategori çështjesh, vetëm për dy prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzim situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është ***më e gjatë*** se standardi minimal kohor i miratuar prej për vetëm 2 nga 9 kategoritë e çështjeve, duke u tejkeluar koha mesatare përkatësisht me 2 muaj e 24 ditë dhe 26 ditë për secilën kategori. Duke analizuar këto kategori çështjesh rezulton se : (i) për kategorinë “civile me palë kundërshtare”, rezulton se nga 28 çështje, afati standard është tejkeluar për 16 prej tyre dhe (ii) për kategorinë “familjare me palë kundërshtare”, afati standard është tejkeluar për vetëm 5 nga 24 çështje.

Po ashtu, në pikëzimin e këtij treguesi, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës pasi rezulton se gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 367 çështje, nga të cilat 181 çështje me palë kundërshtare , duke tejkeluar këtë standardin sasior në fuqi me 101 çështje në vit ose në masën 126 %.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjes, rezulton se koha mesatare që i dedikohet është më e shkurtër se ky afat për 7 nga 9 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për 2 nga kategoritë e çështjeve, ndërkohë që gjyqtarja ka përballuar një ngarkesë të lartë duke tejkeluar këtë standardin sasior në fuqi me 101 çështje në vit ose në masën 126 %. Për këto arsye vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

<sup>58</sup>Metodologjia e Pikëzimit për ketë tregues parashikon se :“... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.



*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se:* Gjyqtarja për vitin 2019 ka përfunduar si relatore gjithsej 367 çështje dhe i janë caktuar gjithsej 468 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarja për periudhën e vlerësimit në total rezulton të jetë **0.78418803 ose 78.4 %**. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i rendimentit 78.4 % pikëzohet me 2/pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe kundërshtimet e projektraportit të vlerësimit, gjyqtarja ka parashtruar se ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh duke mbajtur njëkohësisht edhe funksionin e Kryetares së Gjykatës. Gjithashtu gjyqtarja argumenton se shumë çështje nga organi i akuzës depozitohen në fund të vitit çka rrit numrin e çështjeve pa pasur mundësi për ti përfunduar ato brenda atij viti kalendarik. Po ashtu gjyqtarja ka referuar si shkak që ndikon në rendiment edhe 11 çështje të pezulluara gjatë vitit 2019 ose të pezulluara nga vitet e mëparshme, të cilat kërkon që të konsiderohen në vlerësimin e këtij treguesi.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, rendimenti llogaritet si raport mes numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik. Për këtë arsye, numri i çështjeve të pezulluara gjatë periudhës apo të mbartura nga viti i mëparshëm, nuk ndikon në llogaritjen e rendimentit.

Por referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtares. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 80 çështje. Gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total 376 çështje, nga të cilat 181 çështje themeli, duke tejkaluar standardin sasior në masën 126 %. Për sa më sipër, duke konsideruar edhe arsyet e bëra prezent nga gjyqtarja për volumin e çështjeve të depozituara në muajin dhjetor, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi.

## **KONKLUSIONE:**

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka tejkaluar standardin sasior në fuqi me 126 % , vlerësohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve, pavarësisht se rezulton të jetë 78.4 %, përqindje e cila vlerësohet me 2 pikë, duhet të pikëzohet me 6 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit lidhen përgjithësisht me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 6 pikë, pasi rendimenti prej 78.4 % i përfundimit të çështjeve ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, sikundër është treguesi sasior i punës së saj i cili rezulton i tejkaluar me 126 %.*

## ***2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik,*** rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar nga nenet respektive të K.Pr.P dhe K.Pr.C, është si më poshtë:

- (i) Për çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 6.9 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile ;
- (ii) Për çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 1.08 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- (iii) Për çështje të kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 5.8 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- (iv) Për çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- (v) Për çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”* koha mesatare e arsyetimit është 3 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- (vi) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”* për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, vleftësim ndalimi si dhe zëvendësim/revokim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 1.4 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 dhe 260 i K. Pr. Penale.
- (vii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”* për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit me objekt vleftësim, lejim, apo zgjatje përgjimi, koha mesatare e arsyetimit është 0 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
- (viii) Për çështje të kategorisë *“penale krime”* koha mesatare e arsyetimit është 3.9 ditë, pra dukshëm **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- (ix) Për çështje të kategorisë *“kundërvajtje penale”* koha mesatare e arsyetimit është 5.1 ditë, pra dukshëm **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 pg. i K.Pr.Penale.
- (x) Për çështje të kategorisë *“seancë paraprake – dërgim në gjyq”* për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.8 ditë, pra **më e shkurtër** afati procedural i posaçëm 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh pg 2 i K. Pr. Penale.
- (xi) Për çështje të kategorisë *“seancë paraprake – kërkesë për pushim procedimi”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 6.6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K. Pr. Penale.
- (xii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 2.1 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i K. Pr. Penale.

## KONKLUZIONE:

*Për sa më sipër*, koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor për të katër kategoritë e çështjeve, rezulton më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke treguar shkallë të lartë të aftësisë dhe kujdes maksimal të gjyqtarës për arsytimin e vendimeve në një kohë sa më të shpejtë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.*

### **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

*Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se:*

- (i) Për çështje të kategorisë “*civile me pale kundërshtare*” numri mesatar është 8.6 seanca gjyqësore ;
- (ii) Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*” numri mesatar është 4.56 seanca gjyqësore ;
- (iii) Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*” numri mesatar është 6.3 seanca gjyqësore ;
- (iv) Për çështje të kategorisë “*krime*” numri mesatar është 4 seanca gjyqësore ;
- (v) Për çështje të kategorisë “*kundërvajtje penale*” numri mesatar është 5.2 seanca gjyqësore ;
- (vi) Për çështje të kategorisë “*seanca paraprake*” numri mesatar është 2.4 seanca gjyqësore;

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit e kundërshtimet e bëra në lidhje me projektraportin e vlerësimit lidhur me këtë tregues, ka parashtruar se është treguar e kujdesshme për të planifikuar drejt dhe në kohe seancat gjyqësore si dhe të marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproduktive, duke u kujdesur maksimalisht për zhvillimin e gjykimit në kohën e planifikuar, mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të njoftimeve të palëve, etj. Po ashtu, gjyqtarja parashtron se seancat jo produktive janë shkaktuar nga mosparaqitja e mbrojtësve të palëve, mosformimi i trupit gjykues, etj., dhe asnjëherë shkak për seancat jo produktive nuk kanë qenë mos marrja e masave nga ana e saj.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja në përgjithësi ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes (*urdhër kalim në seancë*

*gjqësore pas ezaurimit të seancës përgatitore/pajtim, apo vendim për kalimin e çështjes në gjykim në çështjet penale)* duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt, urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile apo K.Pr.Penale.

Nga 6 dosje burim vlerësimi, rezulton se për 5 çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short<sup>59</sup> për vlerësim e janë zhvilluar respektivisht 2 - 11 seanca gjyqësore për përfundimin e tyre dhe më konkretisht: 2 (dy) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes me objekt dërgimin e çështjes në gjyq; 3 (tre) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes kundërvajtje penale, proceduar me ritin e gjykimit të shkurtuar; 7 (shtatë) seanca paraprake/gjyqësore për përfundimin e çështjes me objekt pushimin e procedimit penal; 11 (njëmbëdhjetë) seanca gjyqësore për përfundimin e çështjes penale proceduar me ritin e gjykimit të zakonshëm, dhe 4 (katër) seanca gjyqësore çështja familjare me objekt zgjidhjen e martesës.

Seancat janë shtyrë për shkaqe të ndryshme (*disa herë për shkak të mungesës së pajustificuar të organit të akuzës, për shkak të mosmarrjes dijeni dhe mosparaqitjes së të pandehurit apo edhe mbrojtësit të tij, për shkak të njoftimit të dëshmitareve, dhe në 2-3 seanca edhe për shkak të mosformimit të trupit gjykues duke qenë se relatorja e çështjes ka qenë e angazhuar në trajnime në Shkollën e Magjistraturës*). Konstatohet gjithashtu se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati në maksimum prej 20 - 30 ditësh nga njëra – tjetra në çështjen civile/familjare dhe deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale në çështjet penale. Vetëm në disa raste konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës për shkak të lejes vjetore ne muajin gusht. Pra në tërësi shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës. Gjyqtarja në rastet kur palët nuk janë paraqitur, p.sh. i pandehuri apo edhe dëshmitarët pa shkaqe të përligjura, ka urdhëruar shoqërimin e tyre të detyrueshëm konform nenit 351 të K.Pr.Penale dhe 164 të K.Pr.Penale. Gjithashtu në dosjet e vëzhguara është konstatuar si shkak për moszhvillimin e seancave gjyqësore edhe mungesa e organit të akuzës dhe vetëm në një rast rezulton që gjyqtarja ka njoftuar drejtuesin e prokurorisë mbi mungesën pa shkaqe të organit të akuzës në seancë.

Rezulton se 2 çështje burim vlerësimi kanë përfunduar brenda afatit të parashikuar në ligj dhe 1 çështje ka përfunduar brenda standardit minimal kohor nga momenti i regjistrimit të çështjes. Ndërkohë 1 çështje me objekt seancë paraprake me objekt pushimin e procedimit penal ka përfunduar tej standardit minimal kohor prej 2 muajsh, 1 çështje penale ka përfunduar tej afatit standard minimal kohor prej 4 muajsh dhe po kështu edhe çështja familjare me objekt zgjidhje martese ka përfunduar tej afatit 4 muaj të parashikuar për përfundimin e saj.

Rezulton se në 3 raste shkak për shtyrjen e seancave është bërë mungesa e gjyqtarës por për shkaqe të justifikuar (trajnime në Shkollën e Magjistraturës dhe arsye shëndetësore). Në këtë kontekst vlerësohet që gjyqtarja duhej të ishte treguar më e kujdesshme në planifikimin e seancave gjyqësore në ditët e paracaktuara për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese.

---

<sup>59</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur më këtë tregues parashikohet se :*“Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjes (civile, administrative, penale dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse.”*

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit<sup>60</sup> parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja ka treguar një shkallë mesatare aftësie në marrjen e të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet të tyre. Nga ana tjetër ndryshimet në KPrC në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit, i japin mundësi gjyqtarit ta përgatisë çështjen shumë mirë për gjykim, me qëllim që numri i seancave gjyqësore të mos jetë më i madh se 3 seanca. Prandaj referuar numrit mesatar të seancave gjyqësore (më i madh se 3 për 5 nga 6 kategoritë e çështjeve me palë kundërshtarë) dhe shkallës së aftësisë së reflektuar prej saj për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 9 pikë. Në këtë kontekst mbahet në konsideratë edhe përfundimi i gjykimeve brenda afateve orientuese.

## **KONKLUZIONE:**

Bazuar në burimet e vlerësimit, referuar shkallës së kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 9 pikë, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore rezultojnë të jetë më i lartë se 3, për 5 nga 6 kategoritë e çështjeve të analizuar.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 9 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore për shumicën e kategorive të çështjeve, është më i lartë se 3 seanca dhe gjyqtarja ka treguar një shkallë mesatare aftësie në shmangien e seancave joproduktive.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë se:***

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në disa ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale (*nenit 332/1 dhe 333/1 të K.Pr.Penale*). Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet

<sup>60</sup>Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se :”*Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore jo-produktive duke kryer me efikasitet veprime të tilla si:*

- mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit;
- marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse;
- planifikimi i seancave, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjes, afatet ligjore, dhe mendimin e palëve;
- si edhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave jo-produktive.”

ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas rritit të gjykimit të zhvilluar (*nenit 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Ndërkohë në çështjen familjare<sup>61</sup> nuk rezulton që gjyqtarja të ketë caktuar me vendim seancën e pajtimit por ka proceduar me njoftimin e palës së paditur për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes konform nenit 158 të K.Pr.Civile. Pas kalimit të afatit kohor përkatës dhe pas ezaurimit të seancës së pajtimit, ka nxjerrë urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë. Nga 27 seanca gjyqësore, vetëm 2 seanca gjyqësore rezultojnë të filluara me vonesë, ku shkakun nuk është relatuar, por seancat kanë qenë efektive.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për kryerjen e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur në përgjithësi me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shume e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

### **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

#### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

<sup>61</sup> Çështja me nr. regjistri 00235-342, datë regjistrimi 26.04.2019, përfunduar me vendimin nr. 1202-360, datë 11.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Nuk rezulton të jetë ndjekur një rend kronologjik sipas datave të veprimeve procedurale të kryera nga ana e gjykatës, kjo konstatohet kur vendimi i caktimit të seancës gjyqësore është pas të gjitha fletëhirrjeve dhe njoftimeve të palëve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve ne dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj dhe në rastin konkret pavarësisht sa më sipër edhe renditja sipas llojit të akteve procedurale është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.*

## **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesë padia, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve dhe dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.*

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

## 2. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### 3.A Etika në punë

#### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan të dhënat e mëposhtme :*

Sipas shkresës nr. 3056/1 Prot datë 30.12.2020 së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, për gjyqtaren {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë ILD-së. Gjithashtu sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, për gjyqtaren {...}, nuk është dhënë ose zbatuar masë disiplinore.

Në zbatim të nenit 59 pika 4 e Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i ka përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vendimin Nr. 85 datë 13.12.2018 që i përket subjektit të rivlerësimit znj. E.M, aktualisht vendim i formës së prerë, për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik. Në pikën 1 të këtij vendimi është vendosur konfirmimi në detyrë të gjyqtares, ndërsa në pikën 2 të tij është disponuar: “Transferimi i çështjes Nr. 00112-291 të vitit 2018, pranë organit kompetent për t’u marrë në shqyrtim gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit, znj. E.M. ... etj”. Ky disponim detyron organin, në rastin konkret, Këshillin e Lartë Gjyqësor që, sipas nenit 59 pika 4 të Ligjit nr. 84/2016, të fillojë menjëherë shqyrtimin e shkaqeve të referuara, por sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në kushtet e referimit tek ky ligj, trajtimi i menjëhershëm i disponimit të mësipërm, nuk mund të bëhet nga Komisioni, sepse çështja e referuar i përket vitit 2018, dhe jo periudhës së rivlerësimit 2013-2016. Gjyqtarja e referuar nga organet e rivlerësimit është përfshirë ndërkohë në listën e gjyqtarëve për të cilët do të zbatohet programi i vlerësimit të vitit 2020, e cila do të vlerësohet për dy periudha vlerësimi, atë 2013-2016 (për të cilën do të përcaktohet grada) dhe 2017-2019 (vlerësimi normal). Në kushtet kur çështja e referuar i përket vitit 2018, kjo çështje mund të trajtohet vetëm në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares, që i përket periudhës së vlerësimit 2017-2019, për të cilën në zbatim të programit të miratuar dhe detyrimeve të parashikuara nga neni 85 pika 1 e Ligjit për Statusin, vlerësimi fillon në vitin pasardhës, që në këtë rast është viti 2020. Për këtë shkak kjo çështje nuk është trajtuar me përparësi, për sa kohë vlerësimi periodik i gjyqtares do të fillonte në vitin 2020. Nga ana tjetër, në kushtet kur gjyqtarja {...} ka kandiduar për ngritje në detyrë në pozicionet vakante pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit



Durrës, përpos vlerësimit të periudhës 2013-2016 (për të cilën do të përcaktohet grada), me vendimin nr. 634, datë 16.12.2020, “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë”, për gjyqtaren {...} ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2019. Në këtë kontekst, pavarësisht faktit se çështja e referuar për shqyrtim nga Komisioni është e vitit 2018, duke qenë se nuk po procedohet me vlerësimin normal (2017-2019) për gjyqtaren E.M, por me vlerësimin me procedurë të përshpejtuar për vitin 2019 sipas vendimit të sipërcituar, kjo çështje do të duhet të trajtohet në këtë vlerësim.

Referuar vendimit nr. 85 datë 13.12.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas së cilës është vendosur transferimi i çështjes nr. 00112-291 e vitit 2018, pranë organit kompetent për t’u marrë në shqyrtim gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit, Znj. {...} sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016 që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, rezulton se:

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më datë 22.06.2018, është paraqitur një denoncim nga znj. S.D., e cila ka pretenduar se veprimet dhe sjelljet e subjektit të rivlerësimit gjatë seancave gjyqësore janë në shkelje të normave procedurale të një procesi të rregullt ligjor. Denoncuesja ka vënë në dispozicion audion e seancës gjyqësore të datës 12.06.2018, ora 12:00, me të cilën ajo, denoncon sjelljen e subjektit të rivlerësimit në seancat gjyqësore.

Në lidhje me sa më sipër, është hetuar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Me shkresën nr. 6155 prot., datë 17.09.2018, drejtuar Gjykatës së Apelit Korçë është përcjellë vendimi nr. 60 prot., datë 22.06.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë “Për mosmiratimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykim” me të cilin analizohet qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 12.06.2018. Nga kryetarja e Gjykatës së Apelit e cila ka shqyrtuar dorëheqjen e gjyqtarës, deklarohet se nga ana e gjyqtarës sjellja ka qenë korrekte dhe pretendimet e palës nuk qëndrojnë. Lidhur me pretendimin e kërkuarës se gjyqtarja në mënyrë të përsëritur ka cenuar ato si palë, Gjykata e Apelit Korçë është shprehur se është një pretendim i pabazuar referuar përmbajtjes së procesverbalit në audio të seancës të datës 12.06.2018. Sipas kësaj gjykate kërkuarësja S.D., si e paditur i është drejtuar gjyqtarës me fjalët “*je e njëanshme*”. Në këtë moment gjyqtarja i ka thënë të paditurës që të ushtrojë të drejtën e saj për të kërkuar përjashtimin e saj dhe në mënyrë absolute nuk janë përdorur fjalë me përmbajtje kërcënuese.

Në lidhje me këtë ngjarje, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka pyetur subjektin e rivlerësimit e cila në përgjigjet e saj ka shpjeguar se më datë 18.06.2018, është vënë në dijeni se nga pala e paditur është bërë kërkesë për përjashtimin e saj ku si shkak ishte parashtruar se ajo kishte krushqi me paditësin. Pasi ka marrë dijeni për shkakun i ka kërkuar Kancelares së Gjykatës që po atë ditë të vendosej në kontakt me këtë palë për t’i treguar lidhjen e saj me palën paditëse. Më pas është informuar se motra e paditësit, z. K.Ç., është vjehrra e djalit të tezës së nënës së saj. Ndonëse lidhja e mësipërme nuk përfshihej në rastet e heqjes dorë ka vlerësuar të paraqesë kërkesën për heqje dorë. Më datë 21.06.2018, nga ana e kryetares së Gjykatës së Apelit Korçë është vendosur mospranimi i kërkesës për heqje dorë pasi nuk konstatohej asnjë pengesë nga ato të parashikuara nga neni 72/2 i Kodit të Procedurës Civile. Në këtë vendim argumentohet se lidhja e pretenduar nga palët ndërgjyqëse midis mbesës së paditësit dhe një kushërirë të afërt të gjyqtarës, nuk është në shkallën e afërsisë gjinore që

parashikon ligji dhe në këto rrethana nuk mund të përbëjë pengesë për gjyqtaren në gjykimin e kësaj çështje. Më datë 04.07.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se është vënë në dijeni se ishte depozituar një kallëzim penal nga shtetasja S.D. Në po të njëjtën datë ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi, e cila i është pranuar më datë 10.07.2018. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe dokumentacionin e mëposhtëm për të mbështetur deklaratimet e saj: *Shortin e datës 18.06.2018. Kërkesën për përjashtim gjyqtari, datë 18.06.2018, të z. A.D., i cili kërkon përjashtimin e subjektit të rivlerësimit për qëndrim të njëanshëm dhe konflikt interesi duke deklaruar se pretendimet e tij mund të verifikohen me CD audio të seancave të zhvilluara, më datën 26 prill, 17 maj dhe 12 qershor 2018. 97.3 Kërkesën për dorëheqje nga gjykimi, nr. 154 prot., datë 19.06.2018, të subjektit të rivlerësimit drejtuar kryetares së Gjykatës së Apelit Korçë. Vendimin nr. 60 prot., 22.06.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë, "Për mosmiratimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi", me anë të këtij vendimi është vendosur mospranimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes civile me palë të paditur, z. A.D. etj.*

KPK, lidhur me këtë situatë, arsyeton se: *"Nga analizimi i audio seancës së datës 12.06.2018, Komisioni argumenton mbas analizimit të regjistrimit të seancës se thëniet dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit në seancë gjyqësore nuk përputhen me etikën e gjyqtarit dhe parashikimet e ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Këto dispozita përcaktojnë se gjyqtari në një proces është i detyruar që të veprojë si një quria super partes, dhe nuk duhet të zbresë nivelin e komunikimit në debat personal me asnjë nga të pranishmit e tjerë. Gjyqtari drejton procesin me vendime, urdhra dhe udhëzime, nëpërmjet të cilave siguron solemnitet dhe rend e qetësi në sallë, ku të gjithë duhet të jenë të bindurit e saj (quria sententia, summus tacit consetur). Për sa u konstatua në lidhje me komunikimin e subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan të dhëna/prova që të provonin se veprimet e saj ishin të paramenduara, dhe nuk janë të mjaftueshme për ti çmuar ato si sjelle të përgjithshme dhe të vazhdueshme të subjektit, për ta vlerësuar atë me mangësi profesionale dhe për ta identifikuar si magistratë që ka një praktikë punë të papajtueshme me pozicionin.."*

Në këtë kontekst Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka çmuar se sjellja dhe etika në këtë seancë gjyqësore përbën shkak për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të saj sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me sa më sipër, duke qenë se nga vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit referohet për tu vlerësuar sjellja dhe etika e gjyqtares në këtë seancë gjyqësore, u vijua me dëgjimin e CD-së në lidhje me regjistrimin e seancës gjyqësore.

***Nga dëgjimi i CD-së pasqyruar në raportin analitik rezultoi se:*** Në përgjithësi gjyqtarja ka treguar kujdes dhe vetëpërmbytje në drejtimin e procesit gjyqësor dhe në komunikimin me palët në proces. Në seancën e datës 12.06.2018, konstatohet se solemniteti i gjykimit, rendi dhe qetësia në sallë është cenuar për shkak të kërkesave/prendimeve të palëve dhe mosbindjes së tyre ndaj urdhrave të gjykatës. Konkretisht në këtë seancë gjyqësore, gjyqtarja fillimisht ka verifikuar prezencën e palëve në proces në të cilën ka rezultuar se pala paditëse nuk ka qenë prezent. Pas 6 minutash pasi ka filluar seanca gjyqësore është paraqitur pala paditëse dhe gjykata i ka tërhequr vëmendjen për vonesën dhe paralajmërimin me pushimin e gjykimit të çështjes nëse i njëjti veprim do të përsëritej. Gjyqtarja i sqaron palës paditëse se nëse ka hyrë gjyqtarja në sallë dhe ka filluar procesi gjyqësor, asnjë palë tjetër nuk ka të

drejtë të hyjë pas saj. Në këtë moment një prej pjesëmarrësve në sallë ka marrë fjalën pa i dhënë leje gjykata duke i kërkuar gjyqtarës të pushojë gjykimin, pasi pala paditëse nuk është paraqitur në kohë. Gjyqtarja e ka pyetur nëse është palë në gjykim dhe personi i pranishëm në sallë i ka thënë që është djali i një prej palëve të paditura. Pasi ka konstatuar që personi që ka reagu nga salla nuk ka qenë palë ndërgjyqëse në gjykim, gjyqtarja i ka kërkuar të dalë jashtë, sepse ai kishte folur pa leje dhe për më tepër nuk ishte palë në proces, por personi ka vazhduar pretendimet e tij për pushimin e gjykimit, duke sqaruar se si trashëgimtar ligjor kishte edhe ai të drejtën e fjalës. Në këtë moment, gjyqtarja ka ngritur zërin, ka urdhëruar largimin e tij nga salla, duke u shprehur: «*Dil jashtë se flasim ndryshe bashkë pastaj* ». Kjo shprehje është përsëritur disa herë nga ana e gjyqtarës. Nuk rezulton që gjyqtarja ti jetë drejtuar punonjësve të policisë që sigurojnë rendin në gjykim (ndoshta në mungesë të tyre) për të larguar jashtë sallës personin. Në vijim, seanca ka vazhduar me pretendimet e të paditurës S. D (denoncuesja), e cila ka pretenduar se gjyqtarja është e njëanshme, se ajo vetë është e sëmure dhe ndaj ka bërë kërkesa për shtyrje seance dhe shumë pretendime të tjera, ndërkohë që gjyqtarja disa herë i është drejtuar me fjalë që të ulet dhe të qetësohet duke iu drejtuar edhe me fjalët që nëse ka ndonjë pretendim në lidhje me anshmërinë e saj, të bëjë kërkesë sipas ligjit. Duke qenë se e paditura (S.D) nuk i është bindur urdhrave të gjykatës për tu ulur dhe që të mos e ndërpresë gjykatën, gjyqtarja i është drejtuar disa herë edhe me shprehjen «*Ulu, ulu, boll mbajtje fjalim, ulu se të ngrihet tensioni*», kur e paditura i ka thënë se është me tension, etj. Pala e paditur (S. D) i është drejtuar gjithashtu gjyqtarës me fjalët «*se do ta zvarris gjykimin dhe do ti sorollas ashtu siç na kanë sorrollatur edhe ne*». Në këtë moment gjyqtarja i ka thënë sekretarës që ta shënojë këtë tendencë të palës së paditur për zvarritjen e gjykimit. Përsëri pala nuk është ulur dhe nuk ka ndalur së foluri, prandaj gjyqtarja ka urdhëruar që edhe pala e paditur të dalë jashtë duke qenë se nuk i bindej urdhrave të gjykatës. Në përfundim, gjykata ka ndërprerë seancën duke e shtyrë atë për një datë tjetër.

Në seancën e radhës datë 04.07.2018 gjyqtarja pasi ka verifikuar prezencën e palëve, ka bërë një parashtrim të kërkesave për dorëheqje dhe përjashtim si dhe vendimmarrjet përkatëse në lidhje me këto kërkesa (të cilat nuk janë pranuar) dhe në përfundim ka vlerësuar që ti drejtohet përsëri me një kërkesë për dorëheqje, Kryetares së Gjykatës Korçë në kushtet kur pala e paditur kishte bërë kallëzim penal ndaj gjyqtarës, kërkesë e cila rezulton që të jetë pranuar nga ana e Kryetares së Gjykatës së Apelit Korçë.

Për të vlerësuar sjelljen apo jo me profesionalizëm dhe etikë të gjyqtarës referuar materialit të sipërcituar, vlerësojmë me vend të theksojmë paraprakisht se institucionet e administrimit të drejtësisë si gjykatat ashtu edhe profesionet e tjera ligjore, funksionojnë mbi bazë të rregullave të mirëpërcaktuara dhe shfaqjes korrekte dhe profesionale. Qytetaria e treguar në një sallë gjyqi mund të konsiderohet pjesë integrale e procesit të gjykimit. Avokatët dhe palët në proces kanë detyrimin ligjor që të shfaqin sjellje profesionale dhe etike jo vetëm ndaj gjykatës, por edhe përkundrejt njërit - tjetrit dhe pjesëmarrësve në proces. Palët duhet tu binden urdhrave dhe udhëzimeve të gjykatës në funksion të ruajtjes së rendit dhe solemnitetit të gjykimit.

Nga ana tjetër, avokatëve, palëve dhe të gjithë pjesëmarrësve në një proces gjyqësor, një gjyqtar u detyrohet mirësjellje, durim, respekt, diligençë, korrektësi dhe drejtësi. Gjyqtari duhet të ruajë dhe zbatojë standarde të larta të sjelljes dhe duhet t'i respektojë personalisht këto standarde, në mënyrë që integriteti dhe pavarësia e gjyqësorit të ruhen. Një gjyqtar duhet të ketë kontroll në gjykimin dhe menaxhimin e procesit gjyqësor. Gjyqtarët duhet të krijojnë

dhe të shfaqin një klimë profesionalizimi gjatë gjykimit, e cila forcon dhe mbështet dinjitetin e funksionit. Në gjykatë dhe në sallën e gjyqit, një gjyqtar duhet të veprojë gjithmonë me mirësjellje, maturi dhe qytetari duke respektuar dinjitetin e të gjithë pjesëmarrësve në gjykim. Një gjyqtar duhet gjithashtu të kërkojë mirësjellje të ngjashme nga ata që paraqiten para tij ose saj dhe nga stafi i gjykatës dhe të tjerët që i nënshtrohen urdhrave apo kontrollit të gjyqtarit. Qortimet e pajustificuara ndaj avokatëve, vërejtjet fyese për palët ndërgjyqëse ose dëshmitarët, shprehjet jo të hijshme, ironia dhe sarkazma, apo sjelljet e papërshtatshme nga një gjyqtar, minojnë jo vetëm rendin dhe solemnitetin në gjykatë, por edhe vetë integritetin e pushtetit gjyqësor. Kur një gjyqtar ndërhy, ai duhet të sigurojë që paanësia dhe perceptimi i paanësisë nuk janë afektuar negativisht nga mënyra e ndërhyrjes. Sipas këtij parimi, gjyqtari merr masa që sjellja e tij në gjykatë të garantojë dhe rrisë besimin e publikut, të praktikuesve të tjerë të ligjit dhe të palëve tek vetë gjyqtari dhe gjyqësori.

Pra të gjithë aktorët në një proces duhet të sigurojnë që sjellja e duhur dhe korrekte të mbetet një karakteristikë kryesore e ligjërimit të gjykimit, pasi mbi të gjitha profesioni i praktikantëve të ligjit dhe i gjyqtarëve, është dhe bazohet mbi "fjalën". Qytetaria dhe mirësjellja profesionale janë në vetvete detyrime profesionale. Në shumë rrethana, shkelja e këtyre detyrimeve do të përkohë me shkeljen e detyrimeve të etikës dhe sjelljes me profesionalizëm.

Referuar sa më sipër, në lidhje me sjelljen e shfaqur nga ana e gjyqtarës E.Muçi në seancën e datës 12.06.2018, vlerësohet se:

(i) Në rastin konkret, kanë qenë palët ndërgjyqëse në proces apo edhe pjesëmarrësit në sallën e gjykimit të cilët kanë treguar mosrespekt dhe mosbindje ndaj gjykatës, e në këtë kontekst kanë cenuar rendin, qetësinë dhe solemnitetin e gjykimit, si nga pala paditëse e cila ka hyrë në sallën e gjyqit disa minuta pasi ka hyrë trupi gjykues dhe ka filluar seanca gjyqësore, ashtu edhe nga debatet dhe tonet e ngritura të palës së paditur pa iu dhënë e drejta për të folur nga gjykata sikundër parashikojnë të gjitha rregullat procedurale në lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor. Në rastin konkret, palët dhe pjesëmarrësit në sallë kanë shkelur të gjitha detyrimet ligjore duke shfaqur një sjellje të papërshtatshme dhe etike kundrejt gjykatës.

(ii) Duke u ndodhur para një situatë të pamenaxhueshme, për shkak edhe të mungesës së punonjësve për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në sallë, ka ndodhur që në rastin konkret edhe vetë gjyqtarja të ketë reagu, duke humbur kontrollin mbi palët gjatë gjykimit por në funksion të menaxhimit të procesit gjyqësor. Duke qenë se palët nuk iu janë bindur urdhrave të gjyqtarës, të përsëritur disa herë, për të ruajtur qetësinë apo edhe për të dalë jashtë sallës në ato raste kur subjekte pjesëmarrës në sallë kanë folur dhe debatuar pa leje, gjyqtarja u është drejtuar me shprehjet: *"dil jashtë se flasim ndryshe bashkë pastaj"*, apo palës së paditur me fjalët *"boll mbajte fjalim, ulu se të ngrihet tensioni"*. Shprehja *"dil jashtë se flasim ndryshe bashkë pastaj"* e përdorur nga gjyqtarja ndaj një personi i cili në fakt nuk rezultonte që të ishte palë në proces, në tërësinë e saj nuk përmban nota fyese, ironie apo sarkazme. Pa pasur si qëllim që ta legjitimojmë si një fjalë dhe shprehje me vetëpërbajtje, duket që shprehja e mësipërme është përdorur nga ana e gjyqtarës në kontekstin e detyrimit të ushtrimit të autoritetit të largimit forcërisht nga punonjësit e gjykatës, pasi personi nga salla nuk largohej dhe refuzonte të dilte jashtë sallës së gjykimit.

(iii) Nga ana tjetër rezulton se situata në vijim është tensionuar pasi pala e paditur S.D nuk iu është bindur asnjë prej urdhrave të gjykatës për të mos folur pa leje, urdhrin që të ulej, apo edhe urdhrin të gjykatës për tu larguar nga salla. Duke qenë se e paditura shpesh herë i drejtohej gjykatës se është e sëmurë dhe me tension, gjyqtarja i është drejtuar me fjalët që të ulej dhe qetësohej që të mos i ngrihej tensioni, një shprehje kjo, që në kontekstin e përdorur nuk përbën ironi apo sarkazmë.

Në vlerësim tërësor të situatës së ndodhur në rastin konkret, rezulton se të gjithë aktorët pjesëmarrës në proces kanë treguar një sjellje jo të duhur dhe korrekte, ndaj gjyqtarit në radhë të parë duke cenuar autoritetin dhe pushtetin e tij. Nga ana tjetër, edhe vetë gjyqtarja nuk rezulton që ta ketë menaxhuar mirë dhe me vetëpërmbytjen e nevojshme procesin, pavarësisht shkakut dhe rrethanave objektivisht të pamundura nga ana e saj.

Kjo sjellje e gjyqtares, e diktuar nga sjellja e palëve dhe situata e tensionuar e shkaktuar nga palët dhe të pranishmit në sallën e gjykimit, pavarësisht se rezultoi të ketë tejkaluar standardet e sjelljes së kujdesshme dhe me vetëpërmbytje, duke mos zgjedhur çdo herë fjalët apo tonin e përshtatshëm në komunikimin në sallën e gjykimit, rezultoi të jetë një sjellje e cila nuk mund të vlerësohet se cenon standardet etikës në punë për arsyet si më poshtë:

**Së pari** reagimi i gjyqtares dhe fjalët e përdorura prej saj në komunikimin me palët kanë ardhur pas paralajmërimit të përsëritur prej saj për respektimin e solemnitetit dhe rregullave të zhvillimit të seancës gjyqësore;

**Së dyti**, në fjalët e përdorura dhe tonin e zërit në artikullimin e tyre nuk vërehen elementë që mund të kenë cenuar dinjitetin apo integritetin e palëve apo personave të pranishëm në sallën e gjykimit;

**Së treti**, kjo ngjarje është një situatë e izoluar, e cila ka ndodhur në një kontekst ku palët dhe personat prezent në sallë janë përfshirë në një situatë tensioni, komunikimi të papërshtatshëm dhe reagimi jo korrekt, duke vendosur gjyqtaren përballë një situatë të vështirë për tu menaxhuar, me gjithë përpjekjet e saj për të reaguar me qetësi, me qëllim orientimin e palëve për të respektuar solemnitetin e gjykimit;

**Së katërti**, reagimi i gjyqtares dhe shprehjet e përdorura prej saj përbëjnë reagim në një situatë të tensionuar dhe pa pasur mundësi për reflektim paraprak, duke konsideruar edhe faktin që gjyqtari, pavarësisht detyrimit për të ruajtur në çdo rast ekuilibrin dhe gjakftohtësinë në sjelljen e tij, është qenie njerëzore dhe nuk mund të mos ndikohet emocionalisht dhe për pasojë edhe në sjellje, në situata tejet të tensionuara të cilat bëjnë të vështirë ose të pamundur shmangien e reagimit të tij;

**Së pesti**, përveç dy momenteve të reagimit të gjyqtares të cilat, nga fjalët e përdorura, mund të vlerësohen si jo tejet të kujdesshme, në tërësi gjatë zhvillimit të seancave në të cilat ka ndodhur ngjarja, sjellja e gjyqtares ndaj palëve dhe pjesëmarrësve në proces ka qenë dinjitoze, solemne dhe e ekuilibruar, duke treguar respekt dhe vëmendje si dhe ka bërë përpjekje për të shmangur tensionimin e situatës, ruajtjen e rregullit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, vlerësuesi bën një vlerësim të pavarur të shkaqeve të evidentuara nga organet e rivlerësimit sa i përket fakteve në lidhje me etikën dhe shkallën e ndikimit të tyre në kuadër të këtij vlerësimi. Në rastin konkret, duke analizuar rrethanat e faktit dhe kohën e ndodhjes së tij, vlerësohet se gjatë gjithë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ishte përpjekur të shfaqte një sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi, përballë të cilës veprimi si më lart ishte i izoluar si rast dhe jo i një shkalle të tillë që mund të afektonte vlerësimin për angazhimin dhe përgjegjshmërinë e saj në funksion.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e detyrës, prandaj shkalla e etikës së treguar nga gjyqtarja në rastin konkret vlerësohet “shumë e lartë ” duke u pikëzuar me 35 pikë.

### ***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi.***

*Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.*

## **3.B Integriteti i gjyqtarit**

### ***3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.***

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik*, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, për gjyqtaren {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë, gjithashtu sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019- 31.12.2019, për gjyqtaren {...}, nuk është dhënë asnjë e tillë.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr nr. 208/23 Prot datë 29.09.2020, konkludohet se: *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e fakteve të parastruara dhe të analizuara nuk rezultojnë të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmëritë e publikut.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojnë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtares, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjtetin e gjyqtarit.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

### **3.C Paanësia e gjyqtarit**

#### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik,* nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, apo përmbajtjes së formularit të integruar të vlerësimit.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

#### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se për periudhën 01 janar 2019 – 31 Dhjetor 2019, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 7 (shtatë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Nga ana tjetër, rezulton se vetë gjyqtarja ka paraqitur 16 (gjashtëmbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 8 (tetë) prej tyre janë pranuar dhe 8 janë rrëzuar.

### **KONKLUZIONE**

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar dhënave burimore për ekzistencën e

numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit (*asnjë kërkesë e pranuar*), vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik* rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit lidhur me këtë tregues.

#### KONKLUZIONE

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.



**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

#### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik*, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar**

##### **4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik*, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

**Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik** nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim korrekt me stafin e gjykatës.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

**Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik**, rezulton se gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019 ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit.

Konkretisht evidentohet se gjyqtarja {...} përgjatë vitit kalendarik 2019, ka marrë pjesë në 14 (katërmëdhjetë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e pjesëmarrësit, konvertuar në numër ditësh 23 ditë<sup>62</sup>, kohëzgjatje kjo, që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

<sup>62</sup> Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga vetë gjyqtarja, rezulton se ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Referuar dokumenteve të paraqitura nga vetë gjyqtarja të cilat gjithashtu rezultojnë që të jenë edhe pjesë e dosjes personale janë edhe dy çertifikata në lidhje me trajnimet e zhvilluara në vitin 2019.

1. Trajnimi me temë “*Transnational Organized Crime Related to Human Trafficking and Human Smuggling*” 15-19 Prill 2019, zhvilluar në Cavtat, Croatia, organizuar nga U.S Department of Justice Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training, Ministry of Justice Republic of Croatia, U.S Department of State Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs, Projekti Rajonal i Sektorit të Drejtësisë.
2. Trajnimi me temë “*Trajnimit e trajnuesve – hartimi i kurrikulave dhe metodologjia e të mësuarit*”, në Dubrovnik Croatia, 24-26 Shtator 2019, organizuar nga U.S Department of Justice Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training, Ministry of Justice Republic of Croatia, U.S Department of State Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs, Projekti Rajonal i Sektorit të Drejtësisë.

Në tërësi rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 16 aktivitete trajnuese në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur gjithsej 31 ditë trajnimi, duke përbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.*

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, pikëzohet me 20 pikë.*

#### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.**

**Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik**, nuk rezulton të ketë të dhëna që gjyqtari {...} përgjatë vitit kalendarik 2019, të ketë udhëhequr kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional apo të ketë qenë në rolin e ekspertes/lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve.

---

prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrjeje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.*

#### ***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.***

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik*, nuk rezultojnë të dhëna për vitin 2019 nga dosja personale e gjyqtarit në lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e integruar gjyqtarja ka parashtruar se: Gjatë vitit 2019, përkatësisht semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019 në lëndën e “Procedurës Penale” dhe semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020 për lëndën “Procedurë Civile” është angazhuar si pedagoge e jashtme pranë Akademisë Profesionale të Biznesit në sistemin Bachelor dhe atë Master, bashkëpunim i cili ka filluar qysh prej vitit 2014, duke përfshirë edhe lëndë si “E drejta Penale e Përgjithshme”. Në dosjen personale ndodhet edhe kërkesa e gjyqtarës për tu lejuar për të dhënë mësim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, gjyqtarja ka deklaruar se ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera si<sup>63</sup>:

- Pjesëmarrëse pranë Projekti i USAID “Drejtësi për të gjithë” dhe Shkolla e Magjistraturës në Programin e Çertifikimit në “Studime Gjinore”.
- Tryezën e rrumbullakët e organizuar në Shkup Maqedoni e Veriut në datën 23.03.2019 me temë “American Bar Association Rule of Law Initiative (ABA ROLI) Criminal Law Reform Regional Round table”.
- Pjesëmarrëse në Konferencën Rajonale mbi Administrimin e gjykatave dhe menaxhimin e çështjeve”, 11 Nëntor 2019, Tiranë.
- Në vitin 2019 gjyqtarja shpjegon se ka marrë pjesë aktive në grupe pune lidhur me hartimin e moduleve për administrimin e gjykatave, sigurinë në gjykata, sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rritjen e efikasitetit gjyqësor etj.
- Në kuadrin e pjesëmarrjes në takimet e kryetarëve të gjykatave dhe si eksperte në takimet dhe trajnimet në kuadër të projektit “Drejtësi pa vonesa”, gjyqtarja shpjegon se ka dhënë kontribut për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit.

<sup>63</sup> Trajnimet dhe tryezat e rrumbullakëta të vitit të vlerësimit 2019 për të cilën bashkëlidhur formularit të integruar janë paraqitur edhe email-et, programet përkatëse të aktiviteteve.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.*

#### 4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk evidentohen të dhëna për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 31.12.2019

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin "Publikimet ligjore akademike", gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

#### NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		

Vlerësimi i përgjithshëm	383	Shkëlqyeshëm
--------------------------	-----	--------------

## **PROPOZIME DHE REKOMANDIME**

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë, pa cenuar produktivitetin dhe eficientësinë e veprimtarisë gjyqësore, angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvijës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.